DOCUMENT RESUME

ED 177 891 FL 010 632

TITLE	Albanian. Supplementary Materials: Military Interpreting Practice, Vol. 2.
INSTITUTION	Defense Language Inst., Monterey, Calif.
PUB DATE	Jan 66
NOTE	138p.; For related documents, see FL 010 626-631 and FL 010 633-648
AVAILABLE FROM	Defence Language Institute, Foreign Language Center, Nonresident Instruction Division, Presidio of Monterey, CA 93940
LANGUAGE	Albanian
EDRS PRICE	MF01/PC06 Plus Postage.
DESCRIPTORS	Adult Education; *Albanian; Audiolingual Methods; *Classroom Materials; *Instructional Materials; *Language Instruction; *Military Science; Postsecondary Education; *Second Language Learning; Speech Communication; Uncommonly Taught Languages

ABSTRACT

This second of two volumes presents material designed to supplement "Albanian: Basic Course" in the area of military science. A series of question-and-answer exchanges, under various subject headings, is presented in Albanian only. (JB)

****
* Reproductions supplied by EDRS are the best that can be made *
* from the original document. *
****

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE

ALBANIAN

ED177891

SUPPLEMENTARY MATERIAL

(MILITARY INTERPRETING PRACTICE)

VOLUME II

PERMISSION TO REPRODUCE THIS MATERIAL HAS BEEN GRANTED BY

Defense Language Institute

TO THE EDUCATIONAL RESOURCES INFORMATION CENTER (ERIC)."

U.S. DEPARTMENT OF HEALTH, EDUCATION & WELFARE
NATIONAL INSTITUTE OF EDUCATION

THIS DOCUMENT HAS BEEN REPRODUCED EXACTLY AS RECEIVED FROM THE PERSON OR ORGANIZATION ORIGINATING IT. POINTS OF VIEW OR OPINIONS STATED DO NOT NECESSARILY REPRESENT OFFICIAL NATIONAL INSTITUTE OF EDUCATION POSITION OR POLICY

AL010632

DEPARTMENT OF DEFENSE

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE

This pamphlet is for use by the faculty and staff of the Defense Language Institute solely for official purposes. It is NOT for general distribution. It may NOT be released to other persons, quoted or extracted for publication, or otherwise copied or distributed without specific permission in each instance from the Director, Defense Language Institute.

C. W. CHANEY
Colonel, U. S. Army
Director

ALBANIAN

Supplementary Material

Volume II

(Military Interpreting Practice)

January 1966

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE

ANTITANKS

PJESA I

1. Si ju quajnë, Zoti Toger?	Karl Reys Medina.
2. Në cilën njësi jeni, Zoti Toger Medina?	Jam në Batalionin e 2-të të Regjimentit të 113-të Pushkatar.
3. Në cilën njësi të Batalionit të 2-të?	Në Kompaninë Antitanks.
4. Kur ju arrestoi një nga patrullat tona, ju ishit duke ecur rrugës. Ku ishit duke vajtur?	Po venja në sektorin e njërit nga topat tonë.
5. Ç'lloj topash keni në togën tuaj?	Topa antitanks 75 mm.
6. Sa nga këta topa keni në kompaninë tuaj?	Kompania ka dy toga dhe çdo togë ka dy nga këta topa.
7. Sa larg e hedh gjylen një top 75 mm.?	Me këtë top mund të qëllohet gjer më një largësi prej 2563 jardësh.
8. Ç'trashësi mund të çpojë ky top, në qoftë se përdorni municion të posaçëm antitanks?	Pothuaj 4 m. trashësi.
9. Ç'municion tjatër mund të përdorni?	Eksploziv të fuqishëm, fosfor të bardhë.
10. Ku gjëndet sektori antitanks, në të cilën po venit?	Në kryqëzimin e rrugës 77 me rrugën 30.
11. Sa topa keni atje?	Vetëm një.
12. Sa ushtarë t'armatosur e ruajnë?	Atje ka një kompani pushkatarësh me një mitraloz dhe një skuadër pushkatarësh, që gjëndet në një llogore afër kryqëzimit të rrugëvet.

13. Pse keni vetëm një top në këtë kryqëzim rrugësh?

Është edhe një tjatër kryqëzim rrugësh që duhet mbrojtur me topin tjatër.

14. Ku është kryqëzimi tjatër i rrugëvet?

Është nja 600 jardë në lindje të vendit ku më zunë.

15. Sa ushtarë këmbësorie e ruajnë këtë top, n'at pozicion?

Një skuadër.

16. Ç'lloj pengesash keni vënë në kryqëzimin e rrugës 77 me rrugën 30?

Vendin e kemi minuar me mina kundër tanksash dhe me mina kundër njerëzish, për ata që mund të kalojnë andej pari.

17. Tjatër ç'keni atje?

Kemi vënë dy kamiona të shkatërruar dy tonash e gjysmë, për të zënë rrugën.

18. Ç'lloj pengesash keni vënë në kryqëzimin e rrugëvet nga lindja e vendit që thatë?

Xhenioja e ka zënë rrugën me pemë dhe grumbuj gurësh dhe me dhe.

19. Ku gjëndet toga tjatër?

Ruajnë vendin që të mos afrohen tanksat në krahun tjatër të batalionit. Pozicionin e tyre të saktë nuk e di.

20. Sa municion mbani në pozicion, zakonisht?

Nja dhjetë gjyle me eksploziv të fuqishëm, pesë me fosfor të bardhë dhe 25 me eksploziv të fuqishëm antitanks.

21. A është kjo sasi e zakonshme për topin 75 mm.?

Jo, më pëlqente të kisha pasur edhe disa gjyle rezervë. Nuk kisha ndër mend të tërhiqesha.

22. Sa ushtarë keni në kompani, Zoti Toger?

Tre oficerë dhe 65 ushtarë.

23. Paskeni mjaft njerëz! Ç'keni tjatër përveç dy togave antitanks?

Një sekcion komande dhe një togë municioni.

24. Ku gjëndet toga e municionit?

Në Komandën e Kompanisë.

25. Ç'mjete ndërlidhëse keni në pozitën e sektorit të topit?

Hë për hë kemi radio të vjetra model SCR-300 që zakonisht i përdor këmbësoria. Nuk janë shumë të mira; bateritë nuk mbajnë shumë.

26. Pse thatë "hë për hë"? A mos jeni, vallë, në pritje që të ju vijnë radio të reja?

Kam dëgjuar se brenda pak kohe do të na dërgonin disa të modelit PRC-10, të cilat janë më të lehta dhe dëgjohen më larg se ato të modelit 300.

27. Me kë jeni të lidhur me telefon?

Çdo sektor ka një vijë telefonike fushore, të lidhur me komandën e kompanisë më të afërme.

28. Ç'mjete tjera mbrojtëse kundër tanksavet janë në përdorim, në zonën e batalionit tuaj?

Çdo kompani këmbësorie ka nga një predhë hedhëse.

29. Ç'lloji dhe ç'kalibri janë këto predha hedhëse?

Ne i quajmë "bazuka". Janë të kalibrit 2.36, kanë tytë të lëmuet, që mund të ndahet në dy pjesë.

30. Nga cilat pozicione mund të qëllohet me bazukë?

Më këmbë, ndenjur ase barkas, natyrisht, duke e mbështetur mbi sup.

31. Ç'lloj municioni përdorni për këtë armë?

Eksploziv të fuqishëm, eksploziv të fuqishëm kundër tanksavet dhe fosfor të bardhë.

32. Ç'lloj municioni përdor një ushtar për t'u mbrojtur kundër tanksavet?

Përdor granata që hidhen me pushkë. Kanë një granatë hedhëse që i puthitet majës së pushkës dhe me këtë lloj granatë hedhëse mund të qëllojnë me eksploziv të fuqishëm kundër tanksavet ose me fosfor të bardhë.

ANTITANKS

PJESA II

33. Sa kohë keni bërë stërvitje për mbrojtje kundër tanksavet, Zoti Toger?

Kam ndjekur një shkollë dy muajsh për mbrojtje kundër tanksash.

34. Me ç'armë jeni stërvitur gjatë asaj kohe?

Me ato që ju kam thënë më parë: me 75 milimetërshin, me 2 e 36-shin, me pushkën granatë hedhëse; gjithashtu edhe me 57 milimetërshin dhe pak me mina kundër tanksash.

35. Sa peshon kjo bazukë?

Modeli i fundit M9A1 peshon 15.87 lbs.

36. Sa modele të kalibrit 2.36 jeni duke përdorur tani?

Të tëra njësitë përdorin tani modelin M9A1.

37. Sa është e gjatë bazuka?

Nja 61 inç.

38. Sa larg e hedh gjylen?

700 jardë.

39. Sa peshon gjylja?

Të dyja me eksploziv të fuqishëm, antitanks dhe me fosfor të bardhë peshojnë 3.4 lbs. Kemi edhe një gjyle që e përdorim për stërvitje, që ka të njëjtën peshë.

40. Ç'lloj shenjestrash ka kjo bazukë?

Ka një shenjestër të njëjtë me atë tuajën të vendosur n'anë të tytës; ka edhe një shkallëzim në jardë, që vete gradualisht nga zero gjer në 600 jardë me ndërprerje 50 jardësh.

41. Ju thatë se bënit të shtira me eksploziv të fuqishëm antitanks dhe me fosfor të bardhë me këtë pushkë granatë hedhëse. Ç'të shtira tjera mund të bëni me këtë pushkë, duke përdorur granatë hedhësen?

Mund të hedhim edhe fishekzarë.

42. Sa larg e hedh granatën antitanks dhe atë me fosfor të bardhë?

Largësia m'e madhe për të dyja është 300 gjer në 330 jardë. Që t'arrihet kjo largësi duhet përdorur fishek granate M7.

43. Në ç'pozicion mund të shtini me këtë pushkë granatë hedhëse?

Ushtari që përdor këtë armë mund të qëndrojë më këmbë, më gjunjë ose barkas. Në të vërtetë, pozicioni barkas është më i sakti, por edhe më këmbë ose më gjunjë qitja mund të ketë përfundim të mirë po të bëhet praktikë.

44. A mund ta përdorni këtë pushkë për të hedhur granata antitanks duke shtënë me një kënd të gjerë?

Një nga pozicionet më të mira për të shtënë me një kënd të gjerë është duke nienjur përdhe, por është më pak i saktë kundër armaturës.

45. Kur qëlloni me këto armë antitanks kundër armaturës së tanksit, cilës pjesë të tanksit i mateni?

Të shumtën e herës u matemi anëvet. Në qoftë se qëllojmë zinxhirët që lëvizin rrotat, ahere mund të nxiret jashtë përdorimi përkohësisht. Armatura anësh dhe nën tanks është m'e hollë se në çdo vend tjatër, prandaj mundohemi t'a qëllojmë në këto vende.

46. Sa larg qëllon pushka 75 mm.?

Largësia m'e madhe është 4370 jardë, por shenjestra ka të shënuar një largësi që vete gjer në 1900 jardë.

47. A mund t'a përdorni këtë armë kur është errësirë?

Po, ka një vegël me dritë, me të cilën mund t'a shohim shenjestrën kur drita nuk është e mjaftuarshme.

48. Po shenjestrat, a kanë drita për natën?

Përdorin dy llamba të vogla 3 voltësh që ndizen nga dy bateri që përdoren për llambë dore.

49. Çfarë shenjestre ka pushka 57 mm., përveç shenjestrës me teleskop?

Ka edhe një shenjestër të hapur metali M18; mund të përdoret edhe një shenjestër në formë gjeshi që ka përpara.

50. Si është e shkallëzuar në jardë kjo shenjë tër në formë gjethi?

Është e shkallëzuar në ndërprerje 100 jardësh nga 0-1,100 dhe me numra çdo 100 jardë.

51. Nga sa veta përbëhet personeli që nevojitet për këtë armë?

Nga 5 veta: një kryetar skuadre, një që shtie, një ndihmës i tij dhe dy për të mbartur municion.

52. Në ç'pozicion mund të shtihet me këtë armë?

Mund të shtihet më këmbë, ndenjur, më gjunjë dhe barkas.

53. A mund të zbrazet kur është i vendosur mbi një automjet?

Kemi shtënë me 57 milimetërshin duke e mbështetur armën n'anët ose në pjesën e përparme të një kamioni një çerek toni.

54. Sa peshon kjo pushkë?

Dyzet e katër lbs.

55. Sa njerëz nevojiten për t'a mbartur këtë armë?

Për distanca të gjata nevojiten dy veta, kurse për distanca të shkurta mjafton një njeri.

56. Çfarë mbështetse përdoret në tokë për këtë armë, përveç trekëmbëshit të mitralozit?

Ka një dykëmbësh dhe një mbështetse me një këmbë, të cilët janë pjesë të pandara t'armës.

57. Ç'lloj mekanizëm zbrazje përdoret në këtë armë?

Me perkusion.

58. Sa lloje minash kundër tanksash jeni duke përdorur tani?

Tani për tani jemi duke përdorur dy lloje minash sovietike antitanks.

59. Sa eksploziv përmbajnë këto mina?

Nuk kam shumë njohuri mbi minat. Di vetëm se një nga minat ka afërsisht 13 gjer në 15 lbs. dhe një tjatër ka 22 gjer në 26 lbs. eksploziv. Mina m'e vogël ka nevojë për 10 gjer në 20 lbs. presion që të pëlcasi; e madhja ka nevojë për 300 lbs. presion.

MJETE TË KORACUARA - PJESA I

1. Si e keni emrin dhe ç'gradë keni?	Justo Espinoza, kapter.
2. Në ç'njësi jeni?	Jam në Togën e 3-të të Kompanisë së I-rë të Regjimentit të 259-të të tanksavet mesatarë.
3. Ç'detyrë keni në Togën e 3-të?	Jam kapteri i togës.
4. Ç'tanksa ka regjimenti juaj?	Tanksa mesatarë me topa 90 milimetrash.
5. Sa tanksa ka toga juaj?	Tre.
6. Sa veta e përbëjnë personelin e një tanksi dhe cilat janë detyrat e tyre?	Personelin e një tanksi e përbëjnë 5 veta: komandanti i tanksit, artiljeri, shoferi, ndihmësi i shoferit, artiljeri që zbraz topin që gjëndet në krye të tanksit dhe ay që mbush topat.
7. Ç'mision kishit ju, kur u zutë rob?	Toga ime dhe toga e 2-të e kompanisë sonë ishin të caktuara të ndihmonin këmbësorinë gjatë sulmit.
8. Në ç'mënyrë do t'a ndihmonit këmbësorinë?	Kur filloi sulmi, të ndjekur nga këmbësoria, tanksat hapën rrugën. Kur i u afruam objektivit, tanksat duhej të ndaleshin dhe të shtinin kundër objektivit, gjer sa këmbësoria të kishte përparuar, e mbrojtur nga zjarri i topavet tanë. Kur këmbësoria t'ishte në gjëndje të fillonte sulmin e fundit, ata duhej të hidhnin një fishekzar, shenjë kjo që do të thonte se na duhej të pushonim së qëlluari dhe të shkonim përpara gati për të sulmuar objektivin.

9. Sa ushtarë këmbësorie ndihmonit në këtë sulm?

Një batalion.

10. Ç'mjete ndërlidhëse kishit për t'u marrë vesh me tanksat tjerë të togës suaj?

Kemi radio ndër tanksa si tuajat dhe merremi vesht me këto radio ose me shenja.

11. Si merreshit vesh me togat tjera?

Në të njëjtën mënyrë. Ata kishin shenjën me të cilën thirnin dhe ne kishim tonën për komunikime radiofonike. Më të shumtën e herës kemi përdorur radio, posa që toga tjatër, gjatë sulmit ndodhej në krahun e djathtë dhe tepër larg për t'u marrë vesh me shenja.

12. A u mblodhët me togën tjatër para se të fillonte sulmi?

Po, duhej të kontrollonim radiot dhe të dinim rrugën që duhej të ndiqte secili.

13. Ku u mblodhët?

Regjimenti na caktoi për t'u mbledhur një vend në zonën e pyllëzuar, afër vendit ku bashkohet lumi Kansas me lumin Republican.

14. Ç'mjete tjera lufte keni parë në vendin ku u mblodhët?

Ndërsa ishim në vendin e mbledhjes kam parë disa automjete që silleshin poshtë e lart.

15. Ç'automjete ishin këto?

Shumica ishin kamiona dy tonash e gjysmë; kishte edhe ca xhipa.

16. Me çka ishin të ngarkuar kamionat?

Ata që pashë unë, sillnin benzinë dhe municion për 90 milimetërshat. Ca prej tyre kishin gjithashtu gjëra ushqimi në kuti.

17. Ç'automjete tjera kishte?

Kur u futëm në zonën e mbledhjes, vura re se kishte disa armë kundërajrore të kalibrit 50. Secila ishte instaluar mbi një mjet transporti dhe të tëra ishin të fshehura dhe të vendosura mirë.

18. Sa nga këta topa antiajrorë keni parë?

Kam parë tre, por nuk e di në se kishte më shumë ose jo.

19. Ku gjëndet toga tjatër e kompanisë suaj?

E tërë kompania ka vajtur në zonën e mbledhjes dhe për sa di unë, Toga e 1-rë është në rezervë aty afër.

20. Si e kaluat lumin Kansas kur u larguat nga vendi i mbledhjes për të vajtur në pozitën e sulmit?

Më parë kontrolluam urën, që, nga predhat e artilerisë suaj ishte dobësuar aq shumë sa tanksat tanë nuk mund të kalonin mbi të. Shikuam më larg gjatë lumit dhe gjetëm një va.

21. Pasi e kaluat lumin Kansas, ç'udhë ndoqët?

Më të shumtën e kohës na u desh të ndiqnim rrugën. Shiu që ra javën e kaluar e kishte bërë të pamundur të shkuarit rrugë pa rrugë.

22. Cili ishte plani tjatër për këtë sulm, po të binte shi?

Urdhëri që më dha Togë-Komandanti ishte që sulmi të fillonte ashtu siç ishte paraparë dhe do të ndryshohej vetëm po të binte shi i madh. Po të binte shi i madh sulmi do t'u shtynte të paktën 45 orë më vonë, kështu që toka të kishte kohë të thahej dhe të forcohej dhe kështu të kalonin tanksat.

23. Sa automjete të koracuara për transportim trupash do t'u përdornin në këtë sulm?

Asnjë, me sa di unë.

24. Si do të vente përpara këmbësoria krahas me tanksat, në qoftë se ushtarët nuk mbareshin me mjete të koracuara?

Pozicioni nga ku do të fillonte sulmi nuk ishte shumë larg nga objektivi, prandaj plani ishte që këmbësoria të ndiqte tanksat.

25. Ç'plan të përbashkët kishte në mes artilerisë dhe njësive të mortajavet për t'a qëlluar objektivin?

E vetmja informatë që [illegible] është se artileria dhe njësitë e mortajavet do të hapnin zjarr kundër objektivit për të pregatitur sulmin pak kohë para se t'u largonim nga zona e mbledhjes. Di edhe se, së bashku me togën tjatër të tanksavet, vajti edhe një vëzhgues artilerie.

26. Ç'lloj artilerie do t'u përdorte?

Topa Howitzer dhe mortaja 120 mm.

14

27. Zoti Kapter, ju thatë se tanksat në regjimentin tuaj kanë topa 90 mm.; ç'armë tjera janë t'instaluara në këta tanksa?

Në të njëjtin bosht, me topin kryesor është montuar dhe një mitraloz kalibër 30.

28. Në cilën anë të pyrgut gjëndet mitralozi që thatë?

N'anën e mëngjër të 90 milimetërshit.

29. Ç'armë tjera janë të montuara në këtë tanks?

Komandanti i tanksit ka një mitraloz kalibër 50 në ballë të kubes, me të cilin shtie kundër objektivit për tokë ose n'ajr.

30. Kush është përgjegjës për të zbrazurit e mitralozit që është i montuar në një bosht me topin?

Artiljeri, i cili mundet të shtjerë si me 90 milimetërshin ashtu edhe me mitralozin që ndodhet në të njëjtin bosht, me çelsa elektriku ose dore. Njeriu që mbush mitralozin mund t'a zbrazi këtë edhe me dorë.

31. Ç'lloj arme ka në ballë të tanksit?

Në ballë të tanksit ka edhe një mitraloz kalibër 90, të cilin e përdor ndihmës shoferi. Të shumtën e herës ne e quajmë këtë të fundit "artiljeri i ballit të tanksit", sepse ajo është një nga detyrat e tija kryesore.

32. Ç'lloj municioni keni në përdorim për të shtënë me 90 milimetërshin?

Kemi HE (eksploziv të fuqishëm), WP (fosfor të bardhë), HVAP (eksploziv me shpejtësi shumë të madhe që çpon armaturë an'e mb'anë) dhe APC (eksploziv përshkues me kapak).

33. Sa predha për topin 90 mm. keni në depozitën e tanksit?

Për 90 milimetërshin kemi gjithësejt 72 predha. Në këto përfshihen edhe 10 predha që janë përherë në vendin e tyre të posaçëm, gati për të shtënë.

34. Ç'mjete ka tanksi për t'eliminuar gazet që dalin nga zbrazja e topit?	Në tytë të topit është një vrimë nga del gazi dhe një sistem qarkullim ajri brenda në pyrg. Në majë të tytës, d.m.th. në grykë të topit, ka edhe një fre, i cili ndihmon që topi mos të zmbrapset shumë kur zbrazet.
35. Ç'vegla ka artiljeri për të parë kur shtie me 90 milimetërshin?	Ka një teleskop dhe një periskop për qitje direkte dhe kuadranta për qitje indirekte.
36. Ç'vegla kanë njerzit tjerë t'ekipazhit për të parë jashtë tanksit kur kapakët janë të mbyllur?	Shoferi, njeriu që mbush topin dhe artiljeri i ballit të tanksit kanë nga një periskop të montuar në vende të hapura për ta. Edhe komandanti i tanksit ka një periskop dhe dy vrima për kuben e tanksit.
37. Sa peshon ky tanks mesatar?	Peshon afro 46 tonelata.
38. Sa është shpejtësia m'e madhe e këtij tanksi?	Nja 35 mila n'orë. Zakonisht, 20-25 mila n'orë kur shkohet rrugë pa rrugë.
39. Sa benzinë merr?	Ka dy kazanë benzine; njëri merr 100 galon dhe tjetri 133.
40. Sa benzinë shpenzon mesatarisht, në rrugë të zakonshme?	Kur erdhëm në vijën e frontit herën e fundit, kompania ka shpenzuar 4-5 galon për milë për çdo tanks.
41. Ç'thellësi uji mund të kalojë ky tanks mesatar?	Mund të kalojë një va gjer 42 in. thellë.
42. Ç'pjerrësie mund t'i ngjitet ky tanks?	Mund t'i ngjitet një përpjete me 60% pjerrësi.
43. Ç'lloj zinxhirësh përdorni?	Në këto kohët e fundit kemi pasur vështirësi për të gjetur zinxhirë çeliku, prandaj kemi një togë që përdor zinxhirë gome.

44. Cilët zinxhirë kanë dhënë prova më të mira?

Shumicës s' ekipazhit të tanksavet i pëlqejnë zinxhirët prej çeliku, sepse rgjasin më tepër. Zinxhirët prej gome kanë tendencë të çahen dhe të bëhen copa copa, sidomos kur është të ftohët, kështu që duhet të zëvëndësohen shpesh.

45. A keni pasur ndonjë herë ngatërresa me motor?

Jo shumë. Me gjithë këtë, kur bën të nxehtë motori nxehet dhe, në qoftë se jemi duke marshuar, na duhet nganjëherë të ndalemi dhe t'a lëmë të ftohet.

46. Ç'automjete transporti keni në përdorim për të furnizuar kompaninë me benzinë dhe municion?

Në kompani kemi në përdorim dy kamiona dy tonash e gjysmë. Shumë herë kemi pasur nevojë për mjete tjera transporti, por kompania e shërbimit të regjimentit, së cilës na i ndihmojmë, na jep hua mjetet e transportit që na nevojiten.

47. Sa municion mbani në zonën e kompanisë për 90 milimetërshin?

Mbajmë edhe një sasi municioni më tepër se çdo tanks mu në zonën e kompanisë.

48. Ahere, si i furnizoni togat në qoftë se nuk furnizohen nga kompania?

Ne e tërheqim municionin nga regjimenti dhe u a shpiem drejt për drejt togavet dhe këtë shërbim e kryen kompania përkatëse.

49. Si i a bëni për benzinën që ju duhet për automjetet tuaja?

Kemi një depozitë benzine në kompani dhe përdorim kamionat tanë për t'u a shpënë benzinën togavet kudo që të jenë.

50. Ç'automjete tjera transporti keni në kompaninë tuaj përveç tanksavet, kamionavet dhe xhipavet?

Ato janë të vetmet mjete që kemi.

51. Ku ndreqen tanksat kur prishen?

Ndreqjet normale bëhen zakonisht në kompani ose në togë. Në qoftë se kemi nevojë të zëvëndësojmë ndonjë motor ose të bëjmë ndonjë ndreqje të madhe, ahere vemi n'autoparkun e batalionit, pasi aty ka mekanikë me eksperiencë.

KËMBËSORI DHE MJETE TË KORACUARA

1. Si ju a dhanë udhëzimet për këtë sulm, Zoti Kapter?

Togë-komandantët u thirrën në komandën e qendrës së batalionit dhe kur komandanti im u kthye, na njoftoi planin e sulmit.

2. Në ç'vend i mblodhën për t'u dhënë planin e sulmit?

Në vendin e mbledhjes.

3. Ç'bëtë në zonën e mbledhjes ndërsa ishi duke pritur kryetarin e togës?

Kontrolluam edhe një herë tanksat se mos kishin ndonjë të metë, i mbushëm me benzinë dhe u siguruam në se municioni ishte i mjaftuarshëm.

4. Ku gjëndej këmbësoria kur ishi në zonën e mbledhjes?

Trupat e këmbësorisë erdhën në të njëjtin vend të mbledhjes pas një ore që kishim arritur ne.

5. Sa kompani këmbësorie do të prinin në sulm?

Togë-komandanti më tha se Kompania e 1-rë dhe e 3-të e Batalionit të Këmbësorisë do të prinin në sulm. Kompania e 2-të duhej të rrinte në rezervë në rasë se ndonjë nga kompanitë të kishte nevojë për ndihmë.

6. Në ç'vend ndenji në rezervë kjo kompani?

Ndenji në zonën e mbledhjes në Togën e 1-rë të Tanksavet.

7. Sa kohë do të qëndronit aty?

Toga e Tanksavet dhe Kompania e Këmbësorisë duhej të largoheshin nga zona e mbledhjes pas afro pesë minutash që do të largoheshim ne.

8. Si do të venin përpara trupat e këmbësorisë në rezervë pasi të fillonte sulmi?

Tanksat e Togës së 1-rë duhej të mbarnin aq ushtarë sa t'ishte e mundur; të tjerët do t'ecnin prapa tanksavet.

9. Ç'mjete ndërlidhëse kishit me këmbësorinë gjatë sulmit?	Kishim një radio për këmbësori në pyrgun e tanksit. Kemi përdorur edhe shenja por jo kur këmbësoria donte që na të hapnim zjarr mbi ndonjë pikë të veçantë.
10. Në ç'mënyrë tjatër merreshit vesh me këmbësorinë?	Në pjesën e prapme të çdo tanksi ka një telefon, të cilin këmbësoria mund t'a përdori për të llafosur me komandantin e tanksit.
11. Si punon ky telefon?	Në qoftë se nga jashtë ndonjëri e ngre mikrofonin, në pyrg të tanksit ndizet një dritë e kuqe. Në qoftë se komandanti i tanksit dëshiron të flasi me ata të këmbësorisë, ndizet drita e kuqe që gjëndet në kutinë e telefonit, në pjesën e prapme të tanksit.
12. Ku ishte vendi i pikënisjes?	Vendi i pikënisjes ishte në një rrugë fshati që vinte pingul me vendin ku gjëndeshin trupat tona që përparonin.
13. Ç'shenjë u dha për të filluar sulmin?	Nuk u dha asnjë shenjë.
14. Si u lajmua Batalioni se sulmi po fillonte?	Të tërë oficerët dhe nënoficerët rregulluan sahatat dhe më pesë e gjysmë të tërë u vunë në lëvizje.
15. Ku ishte pozicioni juaj nga ku do të sulmonit?	Ishte një pozitë e mbrojtur afro 200 jardë prapa pikënisjes.
16. Si ishte tereni?	Ishte shtrati i një përroi pa ujë, që mbaronte në një gropë.
17. Ç'shenjë u dha për të larguar zjarrin e tanksavet kur këmbësoria qe gati për të bërë sulmin e fundit?	Përdorëm një raketë të kuqe, të cilën e lëshuam me parashutë.

18. Ç'shenjë keni përdorur për të larguar zjarrin e artilerisë dhe të mortajavet?

Një raketë të gjelbër.

19. Keni përdorur dhe një raketë të bardhë. Ç'qe ajo?

Këmbësoria ka qenë e porositur të jepte shenjë me një raketë të bardhë në qoftë se do të kishte pasur nevojë për tym n'objektiv, për të fshehur lëvizjet e trupavet.

20. Ç'lloj armësh do të zbraznit po të përdorej ajo raketë?

Vetëm togat e tanksavet do të merrnin pjesë, pasi ne ishim mjaft afër dhe mund t'a qëllonin më me saktësi.

21. Sa trupave u ka ndihmuar toga juaj?

Toga ime do të bashkëpunonte me Kompaninë e 1-rë të Këmbësorisë. Toga tjatër e tanksavet do të bashkëpunonte me Kompaninë e 3-të të Këmbësorisë.

22. Ku ishte vendosur kompania e armëvet e batalionit?

Mitralozat e rëndë do të ndihmonin, me të shtirat e tyre, nga një vend i lartë pas pikënisjes.

23. Ku ishin vendosur mortajat 81 mm.?

Në kohën kur u nisëm, ato ishin vendosur në krahun e djathtë të batalionit. Kishin hapur zjarr para se të fillonte sulmi.

24. Ç'duhet të bënit pasi këmbësoria t'a pushtonte objektivin?

Ne kishim urdhër të lëviznim drejt objektivit.

25. Në ç'pikë t'objektivit do të gjëndej toga juaj?

Toga ime do të ndihmonte kompaninë e këmbësorisë, me të cilën bashkëpunonim, posa t'arrinim në kodër. Komandanti i Batalionit mendonte se mund të kishim një kundërsulm nga ana e armikut me mjete të koracuara, prandaj kërkoi që ne t'ishim aty si shtesë e mbrojtjes kundër tanksavet.

26. Ç'urdhër kishin togat e tanksavet tjerë?

Të njëjtin urdhër. Ne do t'ishim n'anën e mëngjër t'objektivit, kurse toga tjatër n'anën e djathtë.

XHENIO - PJESA I

1. Nga shënimet që kemi gjetur në letërnjoftimin dhe nga shenjat e uniformës suaj, kuptohet se jeni kapter në Kompaninë e 113-të Pushkatar. Ç'numër ushtarak keni?	2345678.
2. Cila është detyra juaj n'atë njësi?	Jam kapter në degën e togës që ve mina.
3. Cili ishte misioni juaj në kohën kur ju zunë rob?	Isha duke kontrolluar vendin ku kisha urdhër të venja mina, sot pasdreke.
4. Cilin vend të minuar tregon kjo skicë?	Kjo është një skicë e vendit që kam minuar sot në mëngjes?
5. Ve re se skica nuk është e shkallëzuar, por duke e vrejtur skicën më mirë shof se fusha e minuar është në kryqëzimin e rrugëvet Nr. 93104231. Sa është madhësia e zonës që tregon kjo skicë?	50 me 75.
6. Ç'lloj mine tregon ky rreth me shenjën X në skicë?	Janë mina antitanks.
7. Po këta rrathë të zez, ç'janë?	Janë mina kundër njerëzve t.
8. Cila është largësia ndërmjet minavet antitanks?	5 m. nga njëra tjatra.
9. Cila është largësia ndërmjet minavet kundër njerëzvet?	2.50 m. nga njëra tjatra.
10. Cila është largësia ndërmjet minavet kundër njerëzvet dhe atyre antitanks?	6 m.
11. Ç'lloj minash antitanks keni përdorur?	Mina sovietike TM-41
12. Ç'fuqi shtypëse duhet t'ushtrohet mbi një minë antitanks, që të pëlcasi?	350 lbs.

13. Si mund të nxiren jashtë përdorimi përkohësisht minat ruse TM-41?	Për t'a nxjerrë jashtë përdorimi këtë minë duhet çvidhosur burma e kapakut dhe të hiqet ngadalë fitili bashkë me kapsulin.
14. Ç'lloj minash kundër njerëzvet janë në përdorim?	Mina sovietike kundër njerëzvet Pomz-2.
15. Ç'lloj minash tjera antitanks përdoren?	Për sa di unë, vetëm mina sovietike TM-41.
16. Ç'lloj fitili përdoret?	Përdoren fitilë sovietike MUV ose VPF.
17. Ç'fuqi shtypëse duhet t'ushtrohet për t'a ndezur fitilin MUV?	Gjer më 20 lbs.
18. Ç'fuqi shtypëse duhet t'ushtrohet për t'a ndezur fitilin sovietik VPF?	Nuk e di.
19. Si nxiren jashtë përdorimi këta fitilë?	Nuk përgjigjem. Kam dhënë mjaft informata për sa u përket minavet.
20. Si mund t'i njofin ushtarët tuaj vendet se janë të minuara?	Në katër këndet e fushës së minuar është ngulur nga një kunj hekuri me një trekëmbësh metali, afro 6 in. i gjatë dhe 5 in. i gjërë. Këta trekëndsha janë të lyer me ngjyrë të kuqe.
21. Kujt i përndahen këto skica të vendevet të minuara?	Të tëra njësive, të mëdhaja dhe të vogla, të divizionit u epen skica të vendevet të minuara.
22. Zakonisht, kush ju ep urdhër për të vënë mina?	Oficeri i Operacionevet të Regjimentit.
23. Sa liri veprimi keni në vënien e minavet në bazë të skicës që ju është dhënë?	Nuk mund t'a ndryshoj aspak.
24. Sa veta ka kompania e xhenjos?	Ka 5 oficerë dhe 190 ushtarë.

25. Sa veta ka toga që ve mina?	Një oficer dhe 30 ushtarë.
26. Sa veta ka toga e barkavet?	Ka një oficer dhe 76 ushtarë.
27. Sa veta ka toga që merret me ndërtimin e uravet?	Aq sa ka toga e barkavet.
28. Sa oficerë dhe sa ushtarë ka Komanda e Kompanisë?	Dy oficerë dhe 8 ushtarë.

29. Në cilën togë të Kompanisë së 113-të të Xhenios Lëni pjesë?

Në togën e uravet.

30. Ç'ishit duke bërë kur ju zunë rob?

Asgjë. Më zunë rob kur u shpartallua toga jonë.

31. Ç'detyrë kishit në togë?

Punonja në zyrë, në Komandën e Togës.

32. Sa ushtarë dhe sa oficerë ka toga?

Një oficer dhe 75 ushtarë.

33. Sa njerëz ka Komanda e Togës?

Një oficer, Kapteri i Togës dhe një ushtar që punon në zyrë.

34. Ç'bëjnë të tjerët?

Nuk e di.

35. Përveç materialit për ura që ishte në zonën e togës, ku gjëndet pjesa tjatër e materialit?

Në zonën prapa Komandës së Divizionit.

36. Ku gjëndet Komanda e Divizionit?

Nuk e di.

37. Ç'lloj materiali për ura përdor njësia juaj?

Unë di vetëm tri lloje: urë për të ndihmuar këmbësorinë, urë për këmbësorinë M-1938 dhe urë alumini për këmbësorë që rri mbi ujë.

38. Kush e ka bërë këtë material, ose pjesët e tija, që përdoren për ndërtimin e uravet?

Këtë material e kemi mbledhur n'Europë pas Luftës së Dytë Botërore. Këto janë pjesë të bëra në Shtetet e Bashkuara.

39. Për se përdoret ura për ndihmë të këmbësorisë n'ushtrinë tuaj?

Mbi këtë urë kalojnë automjete, municion dhe furnizime.

40. Sa larg njëra tjatrës janë të vëna barkat e sulmit?

Dhjetë këmbë njëra nga tjatra, qendër më qendër.

41. Si është e lidhur kjo urë?

Është e lidhur me tërkuzë, me litar dhe me zinxhirë spirance.

42. Për se përdoret ura për këmbësorë M-1938?

Nëpër këtë urë kalojnë trupa dhe furnizime të mbartura në krah, pasi të jenë shkarkuar trupat sulmonjëse me anën e barkavet.

43. Nga se përbëhet kjo urë?

Nga baza të lidhura njëra me tjatrën.

44. Sa e gjatë është pjesa kryesore (baza) dhe nga se përbëhet?

Baza është 12 këmbë e gjatë dhe është e përbërë nga dy barka që qëndrojnë pezull, nga një dysheme dhe nga dy shtylla për parmakë.

45. Si është e lidhur kjo urë?

Është e lidhur me zinxhirë spirance, me tërkuzë ose litar.

46. Sa është gjatësia dhe gjërësia e kësa ure?

Është 432 këmbë e gjatë dhe 22 in. e gjërë.

47. Ç'peshë mund të mbari secila pjesë pezullonjëse e kësaj ure?

400 lbs.

48. Sa njerëz mund të kalojnë nëpër këtë urë?

Në një urë të tillë të zakonshme mund të kalojnë 75 njerëz në minutë ditën dhe 40 njerëz në minutë natën.

49. Po të forcohet ura, sa njerëz mund të mbari?

Dyfishin e numrit që mbar në kondita të zakonshme.

50. Sa kohë do që të montohet kjo urë?

20 gjer 30 këmbë të një ure të tillë mund të montohen në një minutë nga një togë me eksperiencë. Me njerëz të pastërvitur duhet dyfishi i kohës.

51. Si transferohen copat e kësaj ure?

Për transportimin e kësaj ure nevojiten tre kamiona dy tonash e gjysmë.

52. Për se përdoret ura prej alumini për këmbësorë, që qëndron mbi ujë?

Për kalimin e shpejtë të trupavet të këmbësorisë mbi lumenj të vegjël.

53. M'a përshkruaj urën!

Nuk di. Kam dëgjuar vetëm se ura ishte 315 këmbë e gjatë.

54. Sa njerëz mund të kalojnë mbi të?

Nuk e di.

55. Sa kohë do që të ndërtohet?

Më shpejt se ura për këmbësorë G-1938, por nuk dihet me saktësi sa kohë do që të ndërtohet.

56. Nga se përbëhet kjo urë?

Nuk e di.

PERSONEL I BATERISË S'ARTILERISË FUSHORE
PJESA I

1. Ç'detyrë ke në bateri?	Jam artiljeri i topit Nr.3.
2. Ç'bën si artiljer?	Vendos fitilët dhe bëj gati gjylen.
3. Si i vendos fitilët?	Përdor një vegël që vendos fitilë siedhe një lloj çelsi për të ndërruar fitilë.
4. A ka rënë ndonjë gjyle e artilerisë sonë në zonën e baterisë suaj?	Po, përditë ose çdo dy dit .
5. Ç'mbrojtje keni kundër zjarrit t'artilerisë sonë?	Kemi gropa përreth topit, ku futemi sa herë që na qëllioni.
6. Nga sa veta përbëhet personeli i topit tuaj?	Nga 10 veta.
7. Ç'bëjnë këta njerëz?	Njëri është kryetari i sektorit dhe është marshall. Ka një kapter, që është artiljer, një rreshter, që është ndihmësi i artiljerit, një rreshter tjatër, që është shofer kamioni dhe 6 tetarë, të tërë artiljerë.
8. A e kemi goditur ndonjë herë topin tuaj?	Jo, por dje keni goditur topin Nr.1.
9. A u shkatërrua?	Ashtu menduam në fillim, por reparti i posaçëm e ndreqi pothuaj në një gjysmë dite.
10. A pësoi gjë ndonjë, kur qëlluam kundër jush me top?	Po, u plagosën Komandanti i Togës së 1-rë dhe Kryetari i Sektorit të topit Nr.1.
11. A është plagosur ndonjë në baterinë tuaj?	Po, nja 4-5 veta janë plagosur javën e kaluar.
12. A janë plagosur rëndë?	Jo, infermieri u a lidhi plagët dhe menjëherë u kthyen në krye të detyrës.

29

13. A mendon se kanë qenë me fat?	Po, sepse keni qëlluar shumë mirë.
14. Sa veta shërbejnë në një top në një kohë?	Gjysma e personelit.
15. Pse shërben vetëm gjysma e personelit?	Sepse shërbejnë 24 orë dhe pastaj shkëmbehemi.
16. Ç'masa merrni për t'a mbrojtur topin nga qitjet tona?	E kemi futur topin në një gropë dhe rreth e përqark kemi vënë thasë me rërë.
17. Ç'lloj mbrojtje keni për depon e municionit?	Zakonisht, bëjmë një gropë dhe e fusim municionin brenda. Në qoftë se rrijmë në një vend për një kohë të gjatë, gropës i vëmë pullaz, por në qoftë se rrijmë për pak kohë, municionin e mbulojmë me mushamatë tona.
18. Si quhet komandanti i baterisë suaj?	Quhet Joseph Williams dhe është kapiten.
19. Ç'mendim ke për të?	Është ushtar i mirë.
20. Si e ka emrin komandanti i batalionit tuaj?	Johnson dhe është nënkolonel.
21. Ç'mendim ke për të?	Nuk e njoh, por kam dëgjuar një nga oficerët duke thënë se është burrë i mirë.
22. Me ç'armë je i armatosur?	Me pushkë automatike kalibër .30 .
23. Me ç'armë janë t'armatosur të tjerët?	Edhe ata kanë pushkë automatike kalibër .30 .
24. Ç'armë mbrojtje ka bateria përreth?	Ka dy mitraloza.
25. Sa mitraloza the?	Nuk e di sa janë tamam, por më duket nja 4 a 5, të vendosur pak a shumë përreth baterisë.
26. Ç'ka tjatër përreth bateterisë për t'a mbrojtur?	Kemi ca njerëz që dalin natën për t'a ruajtur.

27. Me ç'lloj mitraloz sh është rrethuar bateria?

Nuk e di ç'marke janë, por Ushtria i quan mitraloza të rëndë dhe janë kalibër .50, HB, M2.

28. Si janë të vendosur?

Mbi një trekëmbësh.

29. A keni në sektorin tuaj armë tjera përveç pushkëvet automatike?

Po, kemi një bazukë.

30. Ç'kalibër ka bazuka?

Tre in. e gjysmë.

31. Sa oficerë ka bateria juaj?

Ka nja 5 a 6. Nuk jam i sigurt se sa ka tamam.

32. Pse nuk je i sigurt se sa oficerë ka bateria juaj?

Disa prej tyre janë vëzhgues që venë përpara dhe rrijnë shumë rrallë prapa, me bateri.

33. Në ç'drejtim ishit duke qëlluar me top?

Ishim duke qëlluar në drejtim të jugut.

34. Sa larg ishit duke qëlluar me top?

Nuk e di lartësinë tamam, por gryka e topit ishte vënë në një pozitë më të lartë se ngahera.

35. Ç'lloj shenjestre përdorni në topin tuaj?

Përdorim shenjestër panoramike Nr.4.

36. Sa herë në minutë mund të qëlloni me këtë top?

Mund të qëllojmë katër herë në minutë për një kohë të shkurtër dhe dy herë në minutë tërë ditën.

37. Nga e merrni municionin?

Dega e municionit e baterisë na e sjell municionin.

38. Sa veta ka sekcioni i baterisë që merret me municion?

Nuk e di. Zakonisht, kam parë 3 veta që e sjellin dhe e dorëzojnë municionin. Nuk para vijnë shumë nga bateria.

PERSONEL I BATERISË S'ARTILERISË FUSHORE

PJESA II

39. Ç'detyrë keni në bateri?

Jam kryetari i një sekcioni të qitjes.

40. Sa i madh është sekcioni i qitjes?

Kam një top Howitzer 122 mm. dhe 9 njerëz.

41. Ç'detyrë keni si kryetar i sekcionit të qitjes?

Detyra ime është të shoh që topi të mbahet mirë.

42. Ç'doni të thoni me fjalët "që topi të mbahet mirë"?

Dua të thom se kam për detyrë të shikoj që topi të mbahet pastër, të jetë përhera gati për qitje dhe të ketë një personel të stërvitur në krye të detyrës tërë kohën.

43. Ju e veni në shenjë topin?

Jo, artiljeri ose ndihmës artiljeri e bën këtë punë.

44. Pse nuk e ve topin në shenjë përhera artiljeri?

Sepse personelin e kam ndarë në dy grupe të ndryshme, kështu që mund të shtiem për 24 orë. Kjo do të thotë se artiljeri dhe ndihmës artiljeri bëjnë të njëjtën punë.

45. Si e mbroni topin?

E fusim në një gropë dhe e rrethojmë me thasë me rërë.

46. A mbani ndonjë njeri përreth topit për t'a mbrojtur?

Jo, kjo është detyra e baterisë. Ne, vetëm e fusim topin në gropë dhe zonën e ka për detyrë t'a ruajë bateria.

47. Ku i merr bateria ushtarët që i nevojiten për të ruajtur topin?

Rojet e nevojëshme për të ruajtur baterinë dërgohen nga sekcioni i municionit, nga sekcioni i mirëmbajtjes dhe nga komanda e baterisë.

48. Sa veta ka dega e municionit?	Ka nëntë veta.
49. Ç'bëjnë këta ushtarë?	Ata sjellin municion nga depoja e batalionit në bateri.
50. Ç'detyrë dhe ç'gradë kanë njerëzit që merren me municion?	Një është marshall, i cili është kryetari i sekcionit, tre janë rreshterë, të cilët janë kryeshofera dhe gjashtë janë ushtarë, të cilët merren me municion.
51. Sa automjete ka në sekcionin e municionit?	Ka 3 kamiona dy tonash e gjysmë me bosht të shkurtër të rrotavet me vinç dhe 3 rimorka M10.
52. Ç'detyrë ka kryeshoferi?	Është një emër sa për formë; ay është shofer kamioni dhe asgjë tjatër.
53. Si e lëvizni topin?	Kemi një kamion dy tonash e gjysmë me bosht të shkurtër të rrotavet me vinç për të tërhequr topin.
54. A e përdorni këtë kamion për ndonjë qëllim tjatër?	Po, me këtë transportojmë tërë personelin dhe materialin tonë.
55. Si e merrni urdhërin për për të qitur me top?	Urdhëri i qitjes i dërgohet qendrës së rregullimit të qitjes; që këtej u dërgohet topavet.
56. Ç'është qendra e rregullimit të qitjes?	Është vendi ku koordinohen qitjet e baterisë.
57. Kush e drejton qendrën e rregullimit të qitjes?	Komanda e baterisë, që është nën urdhër të një oficeri ekzekutiv.
58. Sa njerëz ka qendra e rregullimit të qitjes?	Shtatë veta.

59. Ç'gradë dhe ç'detyrë kanë këta 7 veta?

Dy janë togera, nga të cilët njëri është oficeri ekzekutiv i baterisë dhe tjatri është ndihmësi i tij; një është kapter, i cili është i ngarkuari për llogaritje në qendrën e rregullimit të qitjes, një rreshter mekanik artilerie dhe një rreshter tjatër, i cili mba shënimet e qitjes.

60. Pse keni dy oficerë për të drejtuar një grup kaq të vogël?

Është e nevojshme që një oficer të jetë përherа në krye të detyrës në qendrën e rregullimit të qitjes.

61. Kush e dërgon urdhërin në qendrën e rregullimit të qitjes për të shtënë?

Zakonisht, një nga vëzhguesit që rrijnë përpara, por mund të dërgohet edhe nga batalioni ynë ose nga artileria e divizionit. Nganjëherë, edhe njësitë e këmbësorisë na kërkojnë qitje, të cilave ne u ndihmojmë kur kanë nevojë, por zakonisht, ata kërkojnë me ndërmjetësinë e vëzhguesvet që rrijnë përpara.

62. Sa vëzhgues që rrijnë përpara keni në bateri?

Kemi 3 vëzhgues që rrijnë përpara.

63. Pse 3?

Zakonisht, i ndihmojmë një batalioni këmbësorie dhe i dërgojmë çdo kompanie pushkatarësh nga një vëzhgues.

64. Ç'gradë ka vëzhguesi që rri përpara?

Të tre vëzhguesit janë togera.

65. A bashkëpunon me këmbësori vëzhguesi që rri përpara, vetë, d.m.th. pa ndihmës apo ka ndihmës?

Çdo vëzhgues që rri përpara ka një sekcion që përbëhet nga ay, nga një kapter dhe nga një tetar.

66. Ç'detyrë ka kapteri dhe tetari?

Kapteri është vëzhgues dhe tetari është radist.

67. Sa sekcione tjera të posaçme ka bateria juaj?

Komandën e baterisë, skuadrën e shërbimit të baterisë dhe repartin e mirëmbajtjes.

68. Ç'bëjnë këto sekcione?

Komanda e baterisë merret me të tëra punët administrative. Skuadra e shërbimit të baterisë mbikëqyr në bateri punët e qitjes dhe ve vijat telefonike duke u lidhur me vëzhguesit që rrijnë përpara. Sekcioni i mirëmbajtjes ka në dispozicion tërë personelin e shërbimit të baterisë, si gjellbërës e mekanikë.

69. Si është e organizuar komanda e baterisë?

Nuk e di si është e organizuar skuadra e baterisë dhe sekcioni i mirëmbajtjes. Marshalli rri në komandë, skuadra e shërbimit ka njerëz që merren me komunikime dhe gjellbërësit e mekanikët mvaren nga sekcioni i mirëmbajtjes.

VËZHGUESI QË RRI PËRPARA I ARTILERISË FUSHORE

1. Ku gjëndet artileria juaj?	Bateria ime gjëndet afro 1500 m. në veri të vendit të vëzhgimit.
2. Ku është vendi i vëzhgimit?	Vendi i vëzhgimit ishte në kodrën 452, aty ku më zutë rob.
3. Sa topa ka në baterinë tuaj?	Në baterinë time ka katër topa "Howitzer" 122 mm.
4. Si është e organizuar bateria juaj?	Kemi dy toga për qitje, një togë vëzhgimi, një togë për municion, një togë mirëmbajtje dhe komandën.
5. Sa topa kanë togat e qitjes?	Çdo togë qitje ka dy topa.
6. Topat i tërhiqni me kamiona apo kanë motorë?	I tërheqim.
7. Me se i tërhiqni?	Me kamiona.
8. Sa kamiona keni në bateri?	Nëntë kamiona.
9. Sa të mëdhenj janë kamionat?	Tetë kamiona janë dy tonash e gjysmë me gjashtë rrota dhe një është një çerek toni me katër rrota.
10. Kamionat dy tonash e gjysmë me gjashtë rrota, a janë të tërë njëlloj?	Jo, katër prej tyre përdoren për të tërhequr topa dhe janë model SWB me vinç (SWB d.m.th. me bosht të shkurtër të rrotavet). Katër të tjerët janë të zakonshëm dy tonash e gjysmë me gjashtë rrota.
11. Për se përdoret kamioni një çerek toni me katër rrota?	Është kamioni i komandës për komandantin e baterisë.

12. Si i a thonë emrit komandantit të baterisë tuaj?

Joseph Williams, kapiten.

13. A është komandant i mirë?

Një nga më të mirët. Ka qenë në Shkollën e Artilerisë dhe e di mirë mjeshtërinë e tij. Është i vrazhdë dhe trim, por sillet mirë me tërë personelin e baterisë. E duan të tërë dhe bateria e tij është m'e mira në batalion.

14. Si i a thonë emrit komandantit të batalionit tuaj?

William B. Johnson, nënkolonel.

15. A është komandant i mirë?

Mjaft i mirë. Kam pasur komandantë batalioni më të mirë se atë. Besoj se është më i mirë se shumë tjerë.

16. Si e lajmëroni baterinë kur doni të hapni zjarr?

E thërres me telefon dhe i thom që të fillojë qitjet.

17. A është telefoni e vetmja mënyrë për t'u marrë vesh me ta?

Jo, kam edhe një radio, që e përdor kur s'punon telefoni.

18. Ç'lloj telefoni përdorni?

Për t'u marrë vesh me baterinë përdor telefon model EE8A.

19. Ç'lloj radioje përdorni?

Radio model AN/GRC-6.

20. Si merreni vesh me këmbësorinë?

Me telefon.

21. A e përdorni telefonin EE8A për këtë qëllim?

Jo, për t'u marrë vesh me këmbësorinë përdor telefon me bateri.

22. A keni radio për t'u marrë vesh me këmbësorinë?

Jo, e vetmja mënyrë për t'u marrë vesh me ta është me anë të telefonit me bateri, përveç se kur dal në patrullë me ta.

23. Si merreni vesh me këmbësorinë kur jeni në patrullë me ta?	Na japin një radio, me anë të së cilës merreni vesh me komandën e tyre.
24. Ç'radio është kjo?	Kanë filluar të përdorin një model të ri; besoj se quhet AN/PRC-10.
25. A dëgjohet radioja AN/PRC-10 në baterinë tuaj?	Jo, baterinë më duhet t'a thërras me ndërmjetësinë e këmbësorisë.
26. Si punon ky stacion ndërmjetës?	Unë e thërres këmbësorinë me radio dhe këta i a transmetojnë batalionit tim thirrjen me telefon dhe pastaj batalioni thërret baterinë.
27. Ç'shenjë përdorni për t'u marrë vesh me baterinë tuaj?	Shenja thirrëse e baterisë sime është "Hutini i Bardhë".
28. Ç'shenjë përdorni për të treguar se kush jeni?	Përdor thirrjen "Hutini i Bardhë përpara".
29. Ç'shenjë përdorni për t'u marrë vesh me batalionin tuaj?	Shenja thirrëse origjinale është "Hutë". Të vetmen shenjë thirrëse që kam përdorur është "Huti Nr.3", që është shenja e qendrës së rregullimit të qitjes.
30. Ç'shenjë përdorni për t'u marrë vesh me këmbësorinë?	"Ata janë të zotët për bajonetë".
31. Sa shpesh e ndërroni shenjën e thirrjes?	Për telefon kemi përdorur përhera të njëjtën shenjë thirrëse, por shenjën thirrëse për radio e ndërrojmë çdo dy a tri javë.
32. Cila është shenja thirrëse e radios tuaj?	Edhe për radio kishim të njëjtën shenjë thirrëse, por do të ndërrohej brenda pak ditëve.
33. Ç'objektiv ju lejojnë të qëlloni?	Pothuaj çdo objektiv, vetëm se objektivi duhet të jetë aq i madh sa të ketë një farë vlefte.

34. Sa i madh duhet të jetë një grumbull njerëzish për të qëlluar kundër tyre?

Çdo grup njerëzish që ka tetë ose nëntë veta.

35. A qëlloni përhera kundër 8-9 njerëzve kur janë grumbull?

Jo, disa herë mundohemi t'u afrohemi për të zënë ndonjë rob.

36. Po kundër një kamioni, a qëlloni?

Po, kam urdhër të qëlloj kundër çdo automjeti që të shoh.

37. Sa municion mund të shpenzoni?

Pothuaj sa të dua.

38. Gjer sa municion mund të shpenzoni?

E vetmja herë që m'a kanë kufizuar municionin ka qenë kur kemi pasur një mision të posaçëm qitjesh, për të cilin ishim duke kursyer municion.

39. A d.m.th. se mund të qëllonit 100 herë kundër një grupi të vogël njerëzish?

Jo, nuk jam i lejuar të shpenzoj kot municion. Më duhet të caktoj numrin e duhur të të shtiravet për çdo objektiv.

40. Sa municion mbani për çdo bateri?

Mbajmë aq sa është e nevojshme për çdo top.

41. Sa qitje keni si depozitë bazë për top?

Kemi 250 gjyle si depozitë bazë për top.

42. Pse i quani 250 gjyle si depozitë bazë për top?

Sepse aq mund të transportojmë me mjetet tona të transportit.

43. Ç'lloj municioni përdorni?

Mvaret nga objektivi që duam të qëllojmë.

44. Ç'lloj do të përdornit ju kundër trupavet jashtë?

Unë do të përdorja eksplozivin HE ja me fitil që ndizet në një kohë të paracaktuar, ja me fitil që ndizet posa e prek.

45. Cili fitil punon më mirë?

Fitili VT është m'i miri,sadoqë edhe ay që vendoset me kohë të paracaktuar është i mirë.

46. Ç'lloj municioni do të përdornit kundër trupavet nder llogore?

Unë do të përdorja eksplozivin e fuqishëm kundër tanksavet HE me një përzierje fitilësh. Por në qoftë se trupat janë ndër fortifikata, unë do të përdorja fitil që ndizet me vonesë.

47. Ç'lloj eksplozivi do të përdoronit kundër një kamioni?

Do të përdorja eksplozivin e fuqishëm HE me fitil VT siedhe me fitil që ndizet menjëherë pas të takuarit.

48. A keni ndonjë lloj tjatër municioni përveç atij të tipit HE (NXEHTËSI)?

Po, kemi zjarr, tym dhe fosfor të bardhë.

49. A është municioni që përdorni i fiksuar apo gjysmë i fiksuar?

Është gjysmë i fiksuar.

Shënim.- Municioni "gjysmë i fiksuar" mund t'a ketë gjylen të veçuar nga gëzhoja për t'a rregulluar sasinë e barutit ndërsa "municioni i fiksuar" e ka sasinë e barutit të caktuar dhe të rregulluar në mënyrë që s'mund të preket.

HEAT (NXEHTËSI) d.m.th. eksploziv i fuqishëm kundër tanksavet. VT d.m.th. kohë e ndryshuarshme (që mund të ndryshohet). Fitili "Kohë" ndizet në mbarim të një kohe të paracaktuar. Një fitil me një "shpejtësi të rrufeshme" pëlcet kur takohet. Një fitil që ndizet "me vonesë" shpërthen në 1/32 sekonde pas të takuarit.

50. Sa është largësia m'e madhe që qëllojnë topat tuaj?

Qëllojnë gjer në 14.000 m.

51. Sa është distanca m'e shkurtër që qëllojnë topat tuaj?

350 m.

52. Si i koordinoni qitjet me këmbësorinë?	Përdorim shenja tymi me ngjyra për të qëlluar më larg ditën dhe për natën përdorim fishekzarë që lëshojnë yjë. Ne e vendosim se ç'shenja të përdorim para se të fillojë një operacion ushtarak.
53. Ç'detyrë ka bateria juaj?	Të ndihmojë këmbësorinë.
54. Ç'detyrë ka këmbësoria?	Tani është duke u pregatitur për mbrojtje.

OFICER NDËRLIDHËS I ARTILERISË FUSHORE

1. Ç'detyrë keni?

   Jam oficer ndërlidhës i artilerisë fushore.

2. Ç'bëni pikërisht?

   Punoj me njësinë e këmbësorisë, së cilës është duke i ndihmuar batalioni im dhe ndihmoj në koordinimin e qitjevet t'artilerisë.

3. Me cilën degë të këmbësorisë punoni?

   Punoj drejt për drejt me shtabin e këmbësorisë në komandën e tyre.

4. Me cilin shtab të këmbësorisë punoni?

   Zakonisht, punoj me shtabin e Batalionit të Këmbësorisë, por kam punuar edhe me shtabin e Regjimentit të Këmbësorisë.

5. A ju pëlqen të punoni me këmbësorinë?

   Më pëlqen shumë, pasi kam rast t'u tregoj se sa shumë u vlen artileria.

6. I cilës bateri jeni oficer ndërlidhës?

   Nuk punoj për ndonjë bateri, por punoj me Batalionin e 349-të t'Artilerisë Fushore.

7. Sa oficerë ndërlidhës ka batalioni juaj?

   Batalioni im ka katër oficerë ndërlidhës.

8. Cilat janë detyrat e tre oficerëve tjerë ndërlidhës?

   Ata bëjnë të njëjtën punë që bëj unë.

9. Cili është ndryshimi midis oficerit ndërlidhës që punon me komandën e Regjimentit të Këmbësorisë dhe atij që punon me Komandën e Batalionit të Këmbësorisë?

   Ka fare pak ndryshim. Oficeri ndërlidhës i Regjimentit ka një zonë të madhe, por interesohet për detyrën e tij kryesore, e cila është koordinimi i të tëra qitjeve t'artilerisë që ka në dispozicion për njësinë.

10. Ku është Komanda e Batalionit të Këmbësorisë me të cilën punoni?	Është në ndërtesën prej guri që gjëndet në tatëpjetën veriperëndimore të kodrës 396.
11. Kush është Komandanti i Batalionit të Këmbësorisë?	Është major Williams.
12. Ç'njeri (ushtar) është?	Më duket i mirë. Të tërë në komandë kanë ndërim të madh për të, si njeri të zotin dhe njeri të mirë.
13. Cili batalion i këmbësorisë është ky?	Është Batalioni i 3-të i Regjimentit të 29-të të Këmbësorisë.
14. Ku gjëndet Batalioni juaj i Artilerisë?	Gjëndet në luginën e vogël në perëndim të kodrës 503.
15. Ku gjënden bateritë e qitjes?	Bateria "C" është në luginë me Komandën e Batalionit. Bateria "A" gjëndet në luginë në perëndim të Komandës së Batalionit. Bateria "B" është edhe kjo në luginë nga lindja e Komandës së Batalionit.
16. Si quhen komandantët e baterivet?	Nuk e di. S'kam qenë nga bateritë për një kohë të gjatë dhe kam dëgjuar se ka ndërruar i tërë personeli i tyre. Kapiten Brown-i ka qenë Komandanti i Baterisë "A", Kapiten Smith-i i Baterisë "C" dhe Togn. Peters-i i Baterisë "B".
17. Si e ka emrin komandanti i batalionit tuaj?	William B. Johnson, nënkolonel.
18. A është i zoti n'artileri?	Po, është një nga më të mirët. E di punën e tij shumë mirë. Di çdo gjë që ngjet në batalion dhe i njeh tërë ata që punojnë me të.
19. Kush është komandanti i Divizionit t'Artilerisë?	Është Gjenerali i Brigadës Mike O'Toole.

20. Si është si komandant i përgjithëshëm?	M'i miri që mund të jetë. Të tëra teoritë e tija mbi artileri mësohen në Shkollën e Artilerisë.
21. Ku gjëndet Divizioni i Artilerisë?	Është afro një milë në veri të Komandës së Batalionit, në një pyll gjatë bregut të përroit, aty ku përshkon rrugën.
22. Në cilën anë të rrugës është?	Është n'anën e djathtë të rrugës kur shkoni nga veriu. Është pothuaj 100 m. jashtë rrugës.
23. Është para se t'a kaloni përroin, a pasi t'a kaloni?	Është tamam para se t'a kaloni përroin.
24. Ç'lloj vëzhgimi keni për qitje?	Nuk qëllojmë me vëzhgim direkt, por bazohemi në vëzhguesit që rrijnë përpara dhe në vëzhguesit e ajrit.
25. Ç'është vëzhguesi ajror?	Është një vëzhgues që vete me një aeroplan të vogël mbi tokën e armikut.
26. Sa vëzhgues ajrorë keni në batalion?	Kemi dy aeroplana të vegjël dhe që të dy përdoren si vëzhgues ajrorë.
27. Si viheni në kontakt me vendet ajrore të vëzhgimit?	Kam një radio AN/GRC-6, me të cilën mund të merremi vesh me komandat e vëzhgimit ajror dhe me vëzhguesit që rrijnë përpara.
28. A është kjo radio i vetmi mjet me të cilin merreni vesh me vëzhguesit?	Jo, kam një telefon të lidhur direkt me vëzhguesit që rrijnë përpara dhe në qoftë se ky prishet, ahere mund të përdor telefonet e këmbësorisë. Në rast se nuk mund të vihem në kontakt me vëzhguesit ajrorë me anën e radios sime, mund t'i telefonoj batalionit dhe këta flasin me vëzhguesit ajrorë.

29. A keni vetëm një telefon të lidhur drejt për drejt me batalionin e artilerisë?

Po, por në qoftë se nuk punon mund të thërres me telefon këmbësorinë dhe me ndërmjetësinë e tyre mund të lidhem me batalionin.

30. Kush e bën punën e ritransmetimit?

Thërres regjimentin e këmbësorisë dhe mundohem të lidhem me batalionin e artilerisë me ndërmjetësinë e oficerit ndërlidhës t'artilerisë, i cili është në regjiment. Në qoftë se ky telefon nuk punon, ahere i telefonoj këmbësorisë që të thërresin divizionin dhe pastaj divizioni thërret artilerinë e divizionit dhe më në fund artileria e divizionit thërret batalionin tim.

31. Ku e ka qendrën Komanda e Regjimentit të Këmbësorisë?

Nuk jam i sigurt. Kam qenë vetëm një herë atje dhe ishte errësirë.

32. Ku e ka qendrën Komanda e Divizionit?

Duhet të jetë në qytetin Williamsburg.

33. Në ç'pjesë të qytetit gjëndet?

Nuk e di se ku është tamam, por zakonisht ata zënë ndërtesën më të madhe të qytetit.

OFICERË NDËRLIDHËS (REGJIMENT)

PJESA I

1. Si e keni emrin?	Fabian Rene Voyet, kapiten.
2. Në ç'organizatë jeni?	Jam me shërbim në Komandën e Kompanisë së Regjimentit të 26-të Pushkatar të Këmbësorisë, që bën pjesë në Divizionin e 9-të Pushkatar të Këmbësorisë.
3. Ç'detyrë keni në komandën e kompanisë?	Jam oficer ndërlidhës.
4. Në cilën njësi veproni si oficer ndërlidhës?	Në Regjimentin e 62-të Pushkatar të Këmbësorisë.
5. Nga cili divizion mvaret ky regjiment?	Nga Divizioni i 12-të Pushkatar i Këmbësorisë.
6. Kush është komandanti i këtij regjimenti?	Kolonel Yaban. Besoj se emri i tij i plotë është Rolf Yaban.
7. Ç'lidhje ka Regjimenti i 62-të Pushkatar i Këmbësorisë me Regjimentin e 26-të Pushkatar të Këmbësorisë?	Janë regjimente të vendosura njëri pranë tjatrit. I 62-ti është në të mëngjër ose në jug të 26-tit.
8. Cili është kufiri që i ndan këto dy kufinj?	Rruga Halfa-Martinique.
9. Ç'pararoja ka Regjimenti i 26-të gjatë kësaj vije të kufirit?	Ka një vend shumë të fortë, nja 20 jardë nga rruga. Është në mes të disa pishave të vogla në një kodrinë.
10. A e kryqëzon tash rruga lumin?	Po, ka një urë n'at vend.
11. A është kjo urë e përshtatshme për trafik të madh?	Ç'doni të thoni me fjalën "trafik të madh"?

12. A është e përshtatshme ura për tanksa dyzet tonash?

Nuk jam inxhenjer, por do të thoja se jo.

13. A mund të kalojnë nëpër këtë urë automjete të lehta, si kamiona një çerek toni ose një toni?

Kam dëgjuar se mund të kalojë kamioni dy tonash. Të paktën kështu më ka thënë oficeri i operacionevet të regjimentit, i bazuar në të thënat e inxhenjerëvet.

14. Ç'pararoja ka Regjimenti i 62-të gjatë këtij kufiri?

Ka një pararojë të fortë në mes të pemëvet kundrejt pararojës së Regjimentit të 26-të.

15. Sa njerëz ka në këto pararoja?

Besoj se ka një togë për çdo pozicion, por nuk e di me siguri.

16. Ç'njësi antitanks e mbrojnë këtë urë dhe këtë rrugë?

Ka nja dy topa antitanks të Regjimentit Antitanks të Divizionit tonë, në një vend 100 jardë tej rrugës.

17. Ç'vend (teren) me rëndësi ka afër këtij pozicioni?

Nuk e kam parë kurrë vendin, por sipas hartës, pozicioni është në një bregore të vogël në një kthesë të rrugës.

18. Në ç'drejtim t'urës është ky pozicion?

Pothuaj drejt nga lindja; pak nga jugu, por përhera drejt lindjes.

19. Sa topa antitanks ka dhe ç'kalibër kanë këta?

Ka dy topa 105 mm. me motor, d.m.th. nuk kanë nevojë të tërhiqen.

20. Thatë se këta topa janë të Regjimentit tuaj Antitanks; sa nga këto armë keni në divizion?

Nuk e di, sepse oficeri ndërlidhës i divizionit, kapiten Romanez, disa dit më parë më ka thënë se, disa nga topat me motor janë caktuar për një njësi tjatër. Nuk më ka thënë se për cilën njësi.

21. Në ç'pozicion janë këta topa?

Përveç atyre që tash, s'di gjë tjatër.

22. Ku është vija e qëndresës së pararojës së regjimentit tuaj?

Vija e qëndresës së pararojës është gjatë bregut lindor të lumit Amibque.

23. A keni pozicione tjera, si vende dëgjimi dhe vende për pusi n'anën e perëndimit të lumit?

Për sa kam dëgjuar, s'ka asnjë. Zakonisht kjo është detyra e batalionavet.

24. Si janë të vendosura kompanitë e regjimentit tuaj?

Pritni të mendoj! Kompania e 1-rë është n'anën e mëngjër dhe Kompania e 3-të është fill pas së parës.

25. N'anën e mëngjër të cilit drejtim është Kompania e 1-rë dhe e cilit batalion është kjo kompani?

O, ajo është kompania e Batalionit të 1-rë. Është n'anën e mëngjër në qoftë se silleni me fytyrë nga perëndimi i vijës së frontit tuaj.

26. Tani, më tregoni ku është vija e kufirit ndërmjet këtyre dy kompanive!

Nuk jam i sigurt, por besoj se është lugina që gjëndet afro 900 jardë në veri të kufirit në mes të Regjimentit të 26-të dhe 62-të.

27. Ku është Kompania e 2-të?

Është në batalionin rezervë, n'Aricca.

28. Ç'njësi është në të djathtën e Kompanisë së 3-të?

Batalioni i 2-të.

29. Cila është vija e kufirit ndërmjet Batalionit të 1-rë dhe Batalionit të 2-të?

Është një rrugë e pashtruar që vete poshtë në va të lumit.

30. Ç'tokë (teren) është afër këtij vau?

Përveç një ishulli të vogël në mes të lumit, nëpër të cilin kalon rruga, s'ka tjatër.

31. Sa va ka andej pari?

Nuk e di.

32. Cilët janë kufinjt e njësivet brënda Batalionit të 2-të?

Nuk e di. Di vetëm se Kompania e 2-të dhe Kompania e 3-të janë në vijë të frontit.

33. Ku është Kompania e 3-të? — Nuk kam asnjë ide.

34. Sa larg, më të djathtë, shtrihet Batalioni i 2-të? — Tamam gjer tek Regjimenti i 3-të?

35. Nga cili divizion mvaret, ose më mirë, në cilin divizion bën pjesë Regjimenti i 30-të? — Është pjesë e divizionit tonë.

36. Cila është vija e kufirit ndërmjet këtyre dy regjimenteve? — Përroi Scinie.

OFICERË NDËRLIDHËS (REGJIMENT)

PJESA II

37. Ç'lidhje keni pasur me Regjimentin e 3-të Pushkatar?

Asnjë. Të tëra ato që di për këtë njësi i kam parë në hartë ose i kam dëgjuar në regjiment.

38. Më thoni, ç'i ngjau Regjimentit të 19-të Pushkatar që ishte në vijën e frontit ca dit më parë?

Ca net më parë e kanë larguar nga vija e frontit për të pushuar, duke e zëvendësuar me Batalionin e 30-të. Nuk kam dëgjuar se ku gjëndet tani Regjimenti i 19-të, por edhe ky ka shkëmbyer vend me një tjatër.

39. Ç'doni të thoni me fjalët "ca net më parë"?

Në këtë rast flas për mbrëmë. Shkëmbimi do t'u kryente brënda orës 5 sot në mëngjes.

40. Pse e kanë larguar nga vija e frontit Regjimentin e 19-të?

Mund të jetë një shkëmbim i zakonshëm i regjimentevet, por unë personalisht nuk e besoj. Unë besoj se ata nuk janë në gjëndje të lëftojnë më gjatë sepse janë thyer keqas një javë më parë. Kam dëgjuar se ka humbur 20% t'ushtarëvet.

41. Ku e keni dëgjuar këtë?

M'a ka thënë kapiten Romanez.

42. Le të kthehemi tek regjimenti juaj. Ku gjëndet Kompania e 1-rë e Batalionit të 2-të?

Është në një pozicion blokimi n'afërsitë e kryqëzimit të rrugëvet Conte-Meda dhe rrugës që është si vijë kufiri ndërmjet Batalionit të 1-rë dhe të 2-të.

43. Ku gjëndet Batalioni i 3-të?

Është në pyllin që gjëndet në perëndim të Komandës së Regjimentit.

44. Ku gjëndet Komanda e Regjimentit?	Në fshatin Conte.
45. Ku gjëndet tamam në fshat? M'a përshkruani vendin ku gjëndet komanda!	Komanda është në sallën e Bashkisë, kurse Shtabi Nr.1 i Personelit dhe Shtabi Nr.4 i Furnizimevet gjënden në zyrën e postës. Komandantët banojnë në shtëpinë e Kryetarit të Bashkisë.
46. Ç'mbrojtje ka brenda në fshat për t'a mbrojtur komandën?	Di vetëm se Kompania e 2-të e Batalionit të 3-të i jep roje Komandës së Regjimentit.
47. Ç'njësi tjera ndihmojnë t'a mbrojnë fshatin dhe komandën?	Ka edhe disa topa 75 mm. me motor, që janë të Kompanisë Antitanks; dy nga këta topa i kam parë.
48. Ku gjëndet Kompania Antitanks?	Nuk e di. Topat janë shkëputur nga kompania dhe u janë ngjitur batalionavet.
49. Ku është tamam vendi në të cilin gjëndet Komanda e Batalionit të 3-të?	Është n'anën lindore të një kodre brenda në pyll afro gjysmë mile në perëndim të fshatit Conte.
50. Në cilin drejtim të rrugës që kalon nga perëndimi i fshatit Conte gjëndet Komanda e Batalionit të 3-të?	Kjo rrugë kalon nja 100 jardë nga pylli. Pylli është n'anën e jugut të rrugës.
51. Ku tamam në pyll gjëndet Komanda e Batalionit të 3-të?	Oficeri i Operacionevet të Regjimentit, major Carruba, më ka thënë se gjëndet në shtëpinë e madhe të çiflikut.
52. A gjënden të tëra zyrat dhe pjesët e tjera të Batalionit në shtëpinë e çiflikut?	Nuk e di. S'kam qenë kurrë atje.
53. Kush është komandanti i Batalionit?	Nënkolonel Julius Surranti.

54. Ç'oficer është nënkolonel Surranti?

Më duket se ushtarët nuk e duan shumë.

55. Pse?

Pse, nuk e di. Ka afro një javë që e ka marrë komandën e regjimentit dhe gjer tani as që e kam takuar.

56. Kush është oficeri i operacionevet të regjimentit?

Është një shoku im, kapiten Juan Cesar Philipi. Ky është ay që më ka thënë se ushtarët nuk e duan nënkolonel Julius Surranti-n, por nuk më ka thënë pse.

57. Si është kapiten Philipi si oficer i operacionevet?

Shumë i mirë. Të tërë mendonin se ay do t'u bënte komandant i batalionit.

58. Kush është oficeri i shërbimit të fshehtë të Batalionit?

Është kapiten Jesus Pedro Segura. Kapiten Philipi thotë se është oficer shumë i zoti. Duket se di çdo gjë mbi trupat tuaja kur batalioni është në vijën e frontit. Thuhet se kapiten Segura mund të shkojë në Shtabin Nr.2 të Regjimentit në degën e shërbimit të fshehtë.

59. Pse?

Major Vapistola, oficer i shërbimit të fshehtë të Regjimentit, konsiderohet m'i miri në divizion dhe besohet se do të ngarkohet me detyrën e shërbimit të fshehtë të Divizionit brënda javës. Kapiten Segura do të marrë vendin e tij në regjiment.

OFICERË NDËRLIDHËS (REGJIMENT)

PJESA III

60. Kush është komandanti i regjimentit tuaj?

Nuk dini asgjë mbi njësinë tonë? Është kolonel Fernando Felice.

61. Çfarë komandanti është kolonel Felice?

Është oficer shumë i mirë.

62. Ç'doni të thoni me fjalët "oficer shumë i mirë"?

Besoj se kolonel Felice ka zotësi në taktikë ushtarake dhe sadoqë është i rreptë për sa i përket disiplinës, është i nderuar nga oficerët e regjimentit. Është xhaxhai im.

63. Çfarë oficeri është major Carruba, oficeri i operacionevet?

Koloneli mendon se është shumë i mirë, por unë mendoj se atij i pëlqen të lavdërohet. Kapteri i operacionevet e bën të shumtën e punës së tij. Kapteri i operacionevet është Zoti Vesta.

64. Ju thatë se major Vapistola, oficeri i shërbimit të fshehtë, është shumë i mirë, apo jo?

Po, është një ndër më të mirët. Ay do të bëhet komandant për së shpejti.

65. A mendoni se kapiten Segura do t'i a zëjë vendin në regjiment?

Kështu thuhet.

66. Kush është oficeri i personelit?

Pedro Vespucci. Është shumë i pakënaqur, sepse bën detyrën e një majori kurse vetë është kapiten.

67. Duket se kapiten Vespucci nuk është oficer i mirë, apo jo?

Është oficer shumë i mirë. E vetmja arësye është se gradimet në divizion janë pakësuar.

68. Në tërë divizionin i kanë pakësuar gradimet?

Kështu kam dëgjuar.

69. Nga kush?

Nga kapiten Romanez, oficeri ndërlidhës i divizionit tonë.

70. Po në Regjimentin e 62-të Pushkatar, si vete puna e gradimevet?

Nuk kam dëgjuar ndonjë ankim.

71. Kush është oficeri i furnizimevet në Regjimentin e 26-të?

Kapiten Reno, një oficer i ri; ay është shefi i shërbimevet.

72. Ç'gradë ka, zakonisht, shefi i shërbimevet?

Kapiten.

73. Cilat janë detyrat tuaja të zakonshme si oficer ndërlidhës në Regjimentin e 62-të Pushkatar?

Veproj si agjent personal për komandantin e regjimentit.

74. Ç'misione kryeni për kolonelin, si agjent personal i tij?

Komunikoj planet e patrullës ndërmjet dy njësive, njoftoj regjimentin tim kur Regjimenti i 62-të vete për ndonjë mision të posaçëm. Njoftoj regjimentin tim për shenjat e kundërshenjat që do të përdori Regjimenti i 62-të n'at periudhë 24 orësh. Detyra më me rëndësi që kam, sipas oficerit t'operacionevet, është të dëgjoj oficerin e operacionevet të Regjimentit të 62-të kur ky dhe dy anëtarët e tjerë të shtabit janë duke biseduar mbi operacione t'ardhëshme. Pastaj lajmoj major Vapistola-n mbi këto plane që mund të vihen në zbatim, kështu që Zoti Majori ka dijeni mbi operacionin para njoftimit zyrtar.

75. A mbani shënime për sa u përket këtyre operacioneve të propozuara?

Po, mbaj shënime të plota.

76. Ç'lloj mesazhesh tjera komunikoni, zakonisht, ndërmjet këtyre njësive?

Mesazhe personale dhe plane, me fjalë tjera, gjëra që kanë nevojë për takim ose gjëra të fshehta, të cilat nuk mund t'i besohen komunikimit me anë telegrami ose radioje. Gjithashtu, shpie dhe bie skica nga një njësi në një tjatër.

77. Ç'lloje skicash?

Skica që tregojnë pozicione dhe plane që kanë rëndësi për të dyja komandat.

78. A mund të më jepni një shembëll të një pozicioni që ka rëndësi për të dyja komandat?

Pozicionet e një regjimenti që janë ngjat zonës që mban një regjiment tjatër.

OFICERË NDËRLIDHËS (REGJIMENT)

PJESA IV

79. Ku gjëndet komanda e Regjimentit të 62-të Pushkatar?

Nja një milë në perëndim të qytetit Boise, nga ana e perëndimit të rrugës.

80. Çfarë vendi (tereni) me rëndësi ka afër komandës?

Komanda gjëndet në të vetmin pyll që është n'atë zonë, në qoftë se doni të dini këtë. E quajnë kodra 170, sepse kaq këmbë është lartësia e saj.

81. Në ç'vend në pyll gjëndet komanda?

Një rrugë e pashtruar që ndahet nga rruga kryesore kthehet nga perëndimi aty nga gjysma e pyllit. Komanda gjëndet në këtë kthesë në të dy anët e rrugës. Janë ca pemë, degët e së cilave varen mbi rrugë në një mënyrë t'atillë sa që rruga n'atë vend nuk shihet nga qielli.

82. A gjënden të tëra zyrat e Komandës së Regjimentit n'atë zonë?

Të tëra, përveç qendrës së furnizimevet të regjimentit. Ai instalim quhet "Prapavija e Regjimentit". Nuk e di vendin se ku gjëndet.

83. Përshkruanie rrugën që të shpie nga Regjimenti i 62-të në komandën e regjimentit tuaj!

Kur dal nga Regjimenti i 62-të shkoj gjatë rrugës kryesore që të shpie në qytetin Boise.

84. Çfarë njësishë ushtarake gjënden afër rrugës në mes të Regjimentit të 62-të dhe Boise?

Ka një bateri artilerie, e cila gjëndet në gjysmë të rrugës në mes dy vendeve.

85. E cilës bateri është kjo njësi?

Shenja që kanë vënë në rrugë thotë se është Bateria e 1-rë e Regjimentit të 112-të të Topavet. Për sa kam mundur të marr vesh, ky është një regjiment i ri. Nuk di gjëkafshë mbi këtë njësi, por major Velquei, oficeri i operacionevet të Regjimentit të 62-të, mejton se është njësi e mirë. Është komplet në njerëz dhe në pajisje, sepse jam i sigurt se kam parë katër topa në bateri. Po, po, jam i sigurt se ishin katër topa. Dy ishin më të djathtë të rrugës e dy më të mëngjër. Të tërë janë prapa kodrës së vogël dhe rrjeshtit të pemëvet që fillojnë nga veriu dhe venë nga jugu.

86. Sa larg janë topat njëri nga tjatri?

Kisha për të thënë se janë 50 gjer në 60 jardë larg njëri tjatrit. Po të merret parasysh rruga, fronti i baterisë është i gjatë nja 250 gjer në 300 jardë.

87. Ç'kalibri janë këta topa?

Janë topa 75 mm.

88. Ç'ndërtesa ose baraka ka gjatë kësaj ndërtese?

Me sa kam parë dhe me sa kam dëgjuar unë, nuk ka asnjë.

89. Ç'instalime ushtarake ka në qytetin Boise?

Ka gjithëmonë police ushtarake. Kam parë edhe një qendër furnizimesh, e cila është instaluar gjatë dy a tre ditëve të fundit, megjithëqë nuk e di se ç'është.

90. Si e dini që kjo është një qendër furnizimi?

Më ka thënë një prej policisë ushtarake.

91. Ç'ka tjatër në qytet?

Spitali civil është kthyer në spital ushtarak fushor.

92. Përshkruanie rrugën që merrni pasi të keni arritur në qytet!

Vete në kryqëzimin kryesor të rrugëvet në qytet dhe pastaj kthehem nga e mëngjëra për në rrugën Nr.27. Vazhdoj në këtë drejtim për nja dy mila ose gjer sa arrij aty ku ndahet rruga.

93. Ç'instalime ushtarake ka në mes të qytetit Boise dhe aty ku ndahet rruga?

Me sa di unë asnjë.

94. Vijoni!

Marr rrugën e djathtë sepse është më shkurt. E keqja e kësaj rruge është se kalon shumë afër vijës së frontit dhe kjo është arësyeja që u zura rob. Nuk është faji im, pasi kolonel Felice më ka thënë të shkoja kësaj rruge.

95. Si është e shtruar rruga?

Është e shtruar mirë me zhur.

96. A është e përshtatshme për të kaluar tanksat?

Nuk kam parë asnjë herë tanksa n'atë rrugë, por kam parë gjurmë tanksash mbi sipërfaqe të rrugës. Nuk mbaj mënt se ku dhe kur.

97. Çfarë tanksash?

Nuk di gjë mbi tanksa. Ju thash se kam parë vetëm gjurmët e tyre.

98. Vazhdoni!

Kjo ndarje (degë) e rrugës të shpie në Halfa.

99. Ç'instalime ushtarake ka në mes Halfa-s dhe aty ku ndahet rruga?

Asnjë. Zona është plot me vende ku ka qenë i instaluar kampi ushtarak, por tani nuk ka asnjë njësi atje.

100. Ç'ka në Halfa?

Ka një togë pushkatarësh dhe nja dy topa me motor të Regjimentit të 62-të. Ca dit më parë jam ndaluar dhe kam folur me ta dhe më

kanë thënë se ishin të Regjimentit të 62-të. Topat janë 80 mm. Pushkatarët ishin të Kompanisë së 1-rë të Batalionit të 1-rë rezervë.

101. Ç'ka tjatër në qytet?

Asgjë. Çdo gjë është shkatërruar nga zjarri i artilerisë dhe nga bombardimet ajrore.

102. Si janë të futur në tokë topat me motor?

Janë në gërmadhat e ndërtesavet në perëndim të qytetit dhe mbrojnë rrugën për në Martinique. Pushkatarët i mbrojnë (topat) nga ndonjë sulm që mund të bëjnë ushtarët tuaj të këmbësorisë.

103. Vazhdoni të m'a përshkruani rrugën!

Vazhdoj nëpër qytet gjer sa t'a kaloj qytetin nja një gjysmë mile . N'atë vend është një rrugë që kthehet më të mëngjër ose në veri-perëndim. Është rrugë e pashtruar që të shpie në fshatin Conte.

104. Ç'aktivitet ushtarak ose pozicione ka në mes Halfa-s dhe kësaj kthese?

Asnjë.

105. Ç'pozicione ka në mes kësaj kthese dhe fshatit Conte?

Ka nja dy. Së pari është një rojë që ruan këtë kryqëzim rrugësh ose kthesë. Është e përbërë nga një skuadër e Kompanisë së 1-rë të Batalionit të 2-të. Komunikojnë drejt për drejt me telefon me Batalionin e 2-të.

106. Ç'instalime ushtarake ka në mes këtij vendi dhe fshatit Conte?

Ka një bateri topash howitzer.

107. Cila bateri?

Pritni, jam gabim. Është batalion, besoj Batalioni i 1-rë i Regjimentit të 157-të të topavet howitzer. Nuk jam tamam i sigurt se cili batalion është. Nuk kanë vënë ndonjë shenjë dallonjëse në pozicionin e tyre, por jam i sigurt se harta në pikën ku gjëndet Regjimenti i 26-të e tregon atë si Batalionin e 1-rë. Rruga nuk është shumë afër pozicionevet për të parë qartë dhe topat howitzer janë të fshehur mirë.

108. Në cilën anë të rrugës dhe në ç'distancë gjëndet ky pozicion?

Është në lindje të rrugës dhe kisha për të thënë se është afërsisht nja 400 jardë.

109. Si paraqitet tereni n'atë zonë?

Besoj se ky vend është e vetmja pikë gjatë gjithë rrugës, e cila gjëndet në majë të një vargu malesh. Pozicionet janë të rrjeshtuara në lindje të kësaj maje. Kjo është e vetmja mënyrë që mund t'i përshkruaj pozicionet.

110. Si paraqitet pjesa e përparme?

Nuk e di. Janë të fshehura mirë.

111. Ç'njësi tjera ka në mes këtij pozicioni dhe fshatit?

Nuk e di. Më duket asnjë.

OFICERË NDËRLIDHËS (REGJIMENT)
PJESA V

112. Ku gjëndet Kompania juaj e Mortajavet 120 mm.?

Komanda gjëndet me batalionin rezervë të regjimentit, kurse togat u janë atashuar batalionavet të ndryshëm në vijën e frontit.

113. Ku gjëndet Toga juaj e Sinjalevet të Regjimentit?

Për këtë operacion e kanë shpënë në Kompaninë e Regjimentit.

114. Ku gjëndet Toga e Xhenios së Regjimentit?

Gjëndet në buzë të rrugës duke dalur nga fundi i fshatit Conte.

115. Ku të shpie kjo rrugë?

Të shpie në Meda.

116. Ç'instalime ushtarake ka në Meda?

Të të them të vërtetën, të vetmen gjë që di është Komanda e Divizionit.

117. E cilit divizion?

E divizionit tanë, Divizioni i 9-të.

118. Në ç'vend në qytet gjëndet Komanda?

Nuk e di; kam dëgjuar vetëm se është në qytet dhe këtë besoj se m'a ka thënë Romanez. Unë s'kam qenë kurrë atje.

119. Kush është komandanti i divizionit?

Është Gjeneral Divizioni Rafael Sarle.

120. A është i zoti?

Nuk flitet shumë për të. Ka shumë kohë që është në shërbim dhe konsiderohet si njeri kompetent.

121. Kush është kryetar i Shtabit Madhor të Divizionit të 9-të Pushkatar?

Është Gjeneral Brigade Antonio Veglison. Kam marrë vesh se edhe ky është i mirë.

122. Cilët janë komandantët e Regjimentit të 19-të dhe të 30-të Pushkatar?

Regjimenti i 30-të komandohet nga Alfredo Henroid, i cili është graduar kolonel javën e kaluar. I 19-ti komandohet nga kolonel Hautponl. Nuk e di si e ka emrin e parë, por e di se ushtarët e duan shumë.

123. Pse?

Nuk e di, por kam dëgjuar se ka pasur mjaft ngatërresa në mes trupavet kur u thyen keqas ca kohë më parë.

124. Kush është komandanti i Brigadës së 29-të t'Artilerisë?

Kolonel Solorzano. Nuk i a di as këtij emrin e parë dhe as që kam ndonjë dijeni për të.

125. Kush i komandon Regjimentet e 113-të, 157-të dhe 109-të t'Artilerisë?

Nuk e di. Në këto kohët e fundit janë bërë ndërrime të mëdha n'artileri. Kështu që nuk e di se kush i komandon këto njësi.

126. Ku gjëndet Regjimenti i 38-të Antitanks?

Nuk e di. Automjetet e tyre i kam parë në rrugë, por nuk u a di qendrën.

127. Ku gjëndet Batalioni i 109-të?

Kam dëgjuar kapiten Reno-n duke thënë se është tamam në jug të Meda-s.

128. Ku gjëndet Kompania e 109-të e Sinjalevet?

Nuk e di me siguri, por zakonisht, ata janë me Kompaninë e Divizionit.

62

OFICERË NDËRLIDHËS (REGJIMENT)

PJESA VI

129. Le të kthehemi edhe një herë ke Divizioni i 12-të Pushkatar. Përveç Regjimentit të 62-të, ç'regjimente tjerë ka në divizion?

Është Regjimenti i 54-të dhe i 151-të; Regjimenti i 62-të do të zëvëndësohet për së shpejti nga Regjimenti i 151-të.

130. Kur do të bëhet ky ndërrim?

Besohet të bëhet natën e datës 20 të këtij muaji.

131. Kush e komandon Regjimentin e 151-të?

Kolonel Zamora, po t'a lënë gjer ahere.

132. Ç'doni të thoni me fjalët "po t'a lënë gjer ahere"?

Kolonel Zamora është njeri shumë i ngutshëm dhe po të dojë të bëjë një sulm pa pyetur njeri, ai e bën dhe paraqet gjithëmonë një arësye. Komandantit të Divizionit Germino nuk i pëlqen kjo, por nuk e thotë; i a tregon fytyra, kështu që gjithëkush pret që kolonel Zamora të çkarkohet nga komanda e Regjimentit të 151-të.

133. A keni dëgjuar se kush do t'a zëvëndësojë kolonel Zamora-n?

Jo.

134. Kush e komandon Regjimentin e 54-të?

Kolonel Roberto Bordeaux. Është një njeri që do të ketë rëndësi në t'ardhmen.

135. Çfarë ushtarësh ka Regjimenti i 54-të?

Nuk e di, por kisha për të thënë se janë mjaft të mirë, pasi për së shpejti do të marrin titullin "Pushkatar".

136. Si janë ushtarët e Regjimentit të 62-të?

Me sa kam dëgjuar, nuk janë aq agresivë sa janë ata të Regjimentit të 26-të. Sipas mejtimit tim, është regjimenti m'i dobët në front.

137. A është e mirë artileria e Divizionit të 12-të?

Nuk di asgjë mbi artilerinë e tyre. Me gjithë këtë, duket se Regjimenti i 62-të është i kënaqur për ndihmën që ka marrë nga artileria.

138. A është e vështirë të të zëvëndësohen humbjet në njerëz?

Kam marrë vesh se gjer tani kemi mundur t'i zëvëndësojmë të tëra humbjet. Me gjithë këtë, kam dëgjuar se këtej e tutje do të bëhet përditë e më e vështirë të zëvëndësohen humbjet.

139. A kanë pasur humbje të mëdha Regjimenti i 26-të dhe Regjimenti i 62-të?

Të tërë thonin se asnjë nga regjimentet nuk ka humbur më shumë se 10 ose 12% në një periodë kohe. Të tëra këto humbje janë plotësuar menjëherë me ushtarë të rinj.

140. Ju falem nderit, Zoti Kapiten. Kemi pasur me të vërtetë një bisedim të vogël, por të lezeçëm.

64

MITRALJERI

1. Ti e ke emrin Lazkowsky dhe je rreshter; cila është njësia jote?

   Është Toga e Armëvet e Kompanisë së 1-rë të Pushkatarëvet, e Regjimentit të 4-të Pushkatar e Divizionit të 1-rë Pushkatar të Rojevet.

2. Sa ushtarë ka në Togën e Armëvet?

   Njëzet e dy ushtarë dhe një oficer.

3. Sa mitraloza keni?

   Kemi dy.

4. Kjo është sasia e zakonshme?

   Jo, kemi qenë të detyruar t'a lëmë tjatrin prapa për t'a ndrequr.

5. Ç'modeli dhe ç'kalibri janë mitralozat tuaj?

   Janë të kalibrit 7.62 mm., M 1943 "Goryunov".

6. Përshkruaje si punon: me gaz apo me vegël që pakëson zmbrapjen, ç'peshë dhe ç'gjatësi ka, sa larg shtie dhe me ç' shpejtësi vete predha!

   Punon me rryp fishekësh,që janë të lidhur me njëri tjatrin me një hallkë metali; nganjëherë përdorim edhe rryp stofe. Mban 250 fishekë; tjatri ka vetëm 50 fishekë, por mund t'i bashkojmë ata prej metali për të bërë 250 fishekë. Mitralozi punon me gaz dhe ftohet me anë t'ajrit. Shpejtësia e plumbit është 2620 këmbë në sekondë, por largësia që vret për tokë është 1000 metra. Është i gjatë, besoj, nja 46 inç. Duke qenë se është i rëndë e mbështesim në një trekëmbësh model "Universal 1931". Mitralozi peshon 30 lbs., me gjithë trekëmbësh peshon 89 lbs. Mund të shtiem me të 300 gjer në 400 fishekë në minutë. Ka dorëza në formë të shkronjës D dhe shenjestra në formë gjethi që gjëndet në

	fund të mitralozit, është e shkallëzuar nga 0 gjer në 2000 m. për municion të lehtë 1908-sh dhe nga 0 gjer në 2300 m. për municion të rëndë 1930-sh.
7. Sa mortaja keni në togë?	Vetëm një.
8. Ç'kalibër ka?	82 mm.
9. Sa veta ka skuadra juaj e mitralozit?	Pesë.
10. Ç'detyrë e ç'gradë kanë?	Një kapter si kryetar skuadre, një mitraljer (unë), një ushtar si ndihmës mitraljeri dhe dy ushtarë që mbarin municion.
11. Mitralozat tuaj gjënden në këtë vend afër këtij kryqëzimi rrugësh. Ç'formë ka vendi ku jeni të vendosur?	Është një lloj llogorje e gjatë afro 5 m. dhe e thellë 2 m. e gjysmë në formë t'U-së dhe nga jugu ka një gropë të rrumbullakët. Në buzë të kësaj grope mbi tokë dhe prapa një parapeti dheu të forcuar me thasë me rërë, është i vendosur mitralozi.
12. Si është i vendosur mitralozi n'anën tjatër të kryqëzimit të rrugëvet?	Është tamam prapa ca trupa pemësh të vënë njëri mbi tjatrin; ka edhe një llogore për ushtarët afro një metër thellë. Mitralozi është i vënë në mes dy trupa pemësh të vendosur njëri mbi tjatrin, në mënyrë që mund të zbrazet nga hapësira që ndodhet në mes dy trupave.
13. Çfarë armësh tjera keni, përveç mitralozavet?	Duke përfshirë edhe kapterin, të tërë mbajnë pushkë automatike (mashina) 7.62 mm. model PPS 1943.
14. Si u zgjodh pozicioni që keni?	E zgjodhi kryetar'i togës, Toger Orlov. Kishte një copë letër që po e shikonte dhe më duket se ishte nga

batalioni ose regjimenti. Ishte e bukur, kishte shumë shigjeta dhe vija të bëra me pika me numrin e batalionit tonë të shkruar ndër disa radhë të bëra me pika.

15. Ç'mjete transportimi ka toga jote?

Dy kamiona 4 X 2 Gaz-1951-sh i janë caktuar togës. Zakonisht përdoren për mortaja.

16. Sa municion-bazë për luftim keni?

Nuk e di.

17. Ku e merrnit municionin?

Besoj se në vendin e furnizimevet të Batalionit.

18. Sa të çuara e sa viaska ka tyta e mitralozit tuaj?

Nuk e di.

PERSONELI SHËNDETËSOR

PJESA I

1. Në ç'njësi jeni, Zoti Kapter?	Jam në Togën e Shëndetësisë së Regjimentit të 142-të Pushkatar të Divizionit të 30-të Pushkatar.
2. Ç'mision kishit në kohën kur ju zunë rob?	Isha duke shikuar për të plagosur.
3. Kush ju dha urdhër të shikonit për të plagosur?	Toger Gonzales.
4. Ç'detyrë ka Toger Gonzales?	Është Shefi i Sekcionit të Shëndetësisë me shërbim të veçantë pranë Batalionit të 1-rë.
5. Batalioni i 1-rë i cilës njësi, Zoti Kapter?	Batalioni i 1-rë i Regjimentit të 142-të Pushkatar.
6. Ç'detyrë keni në këtë njësi?	Jam kapteri i sekcionit.
7. Sa veta keni në këtë sekcion?	Një oficer, 6 nënoficerë dhe tre ushtarë.
8. Ç'gradë dhe ç'detyrë kanë këta njerëz?	Ka një kapter sekcioni, dy rreshterë dhe tre ushtarë; të tërë janë infermierë.
9. Pse ju dërguan juve për të kërkuar për të plagosur?	Sepse të tjerët ishin të zënë duke mbledhur të plagosur tjerë gjatë vijës së frontit.
10. Ju u zutë rob nga patrulla jonë n'orën 18 në këtë vend. Ku gjëndet njësia juaj në lidhje me vendin ku u zutë?	Gjëndet 1200 m. nga linija e vendit ku u zura rob.
11. Ç'njësi është kjo?	Është stacioni i shërbimit shëndetësor të batalionit.

12. Ç'instrukcione kishit për të gjetur vendin se ku ishin të plagosurit?

Më thanë të ndjek rrugën e pashtruar nga perëndimi, gjer sa t'arrija ke kthesa që bën rruga. Në këtë kthesë rruga shkon nga jugperëndimi, por unë duhet të vazhdoja gjithënjë nga perëndimi duke vajtur rrugë pa rrugë. Pasi të kaloja një gropë uji, më thanë se aty ishte një lumë 200 m. nga perëndimi i kthesës së rrugës. Të plagosurit duhet t'ishin 400 m. në perëndim të këtij vendi. Nuk i gjeta sepse ushtarët tuaj më zunë rob menjëherë sa e kalova lumin.

13. Si e gjetët rrugën e pashtruar që ka kthesën që thatë?

Qe shumë e lehtë. Stacioni i shërbimit shëndetësor të Batalionit të 1-rë dhe komanda e këtij batalioni gjënden ndër çadra në veri të kësaj rruge. Rruga kalon nga lindja në perëndim përpara stacionit të shërbimit shëndetësor dhe komandës së batalionit.

14. Sa ura kaluat duke vajtur nga stacioni i shërbimit shëndetësor gjer ke kthesa e rrugës?

Kam kaluar dy ura.

15. Sa larg nga ura e parë që kaluat sot në mëngjes gjëndet komanda dhe stacioni i shërbimit shëndetësor?

Njëqind metra.

16. Çfarë copa artilerie keni vënë re kur po shkonit nga komanda gjer ke kthesa e rrugës?

Rrugës sot në mëngjes nuk kam parë as mortaja as topa, sepse ishte gjithënjë errësirë kur arrita ke lumi.

17. Sigurisht, Zoti Kapter, duhet të keni dëgjuar motorë tanksash në lëvizje, të shtira topash ose njerëz duke lëvizur ose llafosur!

Kam dëgjuar të shtira topash, por nuk e di llojin e topavet dhe vendin se ku gjëndeshin. Kam dëgjuar njerëz duke llafosur në gropën

që ju thash, por nuk mund t'a caktoj vendin dhe numrin e saktë të tyre. Nuk kam dëgjuar tanksa.

18. Sa oficerë dhe sa ushtarë ka në togën tuaj të shëndetësisë?

Katër oficerë e 26 ushtarë.

19. Ç'gradë kanë?

Një është kapiten, 3 janë togera, një është kapter toge, 8 janë rreshterë, 4 janë kaptera sekcioni dhe 13 janë ushtarë.

20. Si janë t'organizuar këta oficerë dhe ushtarë?

Kapiteni është kryetari i togës. Toga ndahet në katër sekcione. Çdo sekcion që u dërgohet tre batalionave ka një toger, një kapter sekcioni, dy rreshterë dhe tre ushtarë. Kapiteni, kapteri i togës dhe një ushtar formojnë togën e shtabit në regjiment. Pjesa tjatër e personelit: një kapter sekcioni, dy rreshterë dhe tre ushtarë formojnë stacionin e shërbimit shëndetësor të regjimentit.

21. Sa njerëz janë plagosur në batalionin tuaj gjatë javës së kaluar?

Nuk e di se sa janë plagosur gjatë asaj jave, por di vetëm se dje soliën 14 ushtarë të plagosur.

22. Sa njerëz janë vrarë në luftim gjatë po asaj kohe?

Nuk e di.

23. Cilat armë e kanë shkaktuar shumicën e humbjeve?

Mitralozat e lehtë, pushkët dhe pushkët automatike.

24. Ç'armë kanë frikë më shumë ushtarët?

Copat e artilerisë.

25. Ku i merr furnizimet mjekësore stacioni i shërbimit shëndetësor të batalionit?

Në stacionin e shërbimit shëndetësor të regjimentit.

26. Sa gjak të depozituar ka stacioni i shërbimit shëndetësor të batalionit?	Nuk e di sasinë ekzakte, por nuk mungon kurrë.
27. Sa morfinë e sa penicilinë ka zakonisht stacioni i shërbimit shëndetësor?	Nuk e di.
28. Ç'ilaçe tjera mban stacioni i shërbimit shëndetësor?	Asnjë.
29. Ç'sasi aspirine APC kanë?	Një arkë ushtarësh plot.
30. Ç'furnizime tjera ka stacioni i shërbimit shëndetësor?	Lidhe e pambuk.
31. Ku bëhen operacionet?	Në spitalin fushor.
32. Ku gjëndet spitali fushor?	Nuk e di. Ne i tërheqim të tërë të plagosurit tanë me anën e shërbimit shëndetësor të regjimentit.
33. Ku gjëndet stacioni i shërbimit shëndetësor të regjimentit?	Në fshatin Kools.
34. Në ç'vend në fshatin Kools gjëndet stacioni i shërbimit shëndetësor?	Në ndërtesën e bashkisë.
35. Ç'studime mjekësore kanë kryer oficerët e togës?	Të tërë janë të diplomuar në mjekësi.

PERSONELI SHËNDETËSOR
PJESA II

36. Si ju ka trajtuar njeriu që ju pyeti, Zoti Toger?	Mirë.
37. Keni treguar shumë zell në kryerjen e detyrës suaj duke mos pranuar t'i lëni të plagosurit kur stacioni i shërbimit shëndetësor u zaptua nga fuqitë tona.	Mjeshtëria ime është për t'u kujdesuar për të sëmurë dhe të plagosur.
38. Sa ampula morfinë ka zakonisht në dispozicion stacioni i shërbimit shëndetësor të batalionit?	Pesëdhjetë gjer në shtatëdhjetë ampula.
39. Sa shishe 250 cm.^{3} (centimetër kubik) me gjak keni në dispozicion?	Zakonisht, dhjetë shishe, por mund të kemi edhe më shumë; mvaret nga gjendja.
40. Sa shishe 500 cm.^{3} me gjak keni?	Dhjetë.
41. Sa gram aspirinë APC ka stacioni jumj i shërbimit shëndetësor?	Dy shishe. Një shishe ka 1000 aspirina.
42. Sa njësi penicilinë keni në dispozicion?	Kemi dy kuti me penicilinë.
43. Sa doza ose sa shishe ka një kuti?	Nëntëdhjetë e gjashtë shishe.
44. Sa njësi penicilinë ka një shishe ose një dozë?	300.000 njësi.
45. Sa rrotulla lidhe ka stacioni i shërbimit shëndetësor?	Nja 80 rrotulla lidhe. 50 prej tyre kanë një gjërësi 3 in. dhe 2 in.
46. Sa kilogram pambuk keni në dispozicion?	Dhjetë gjer në pesëdhjetë kilogram.

47. Ç'sasi uji të distiluar ka stacioni i shërbimit shëndetësor?	Kemi dy kuti; një kuti ka gjashtë shishe dhe çdo shishe ka 1000 cm.^{3} ujë.
48. Sa vigje ka shërbimi i stacionit shëndetësor?	Gjashtë.
49. Sa rrypa vigjesh për të lidhur të sëmurët keni pasur?	Tetëmëdhjetë rrypa; tre rrypa për çdo vig.
50. Sa merthiolate keni në dispozicion?	Nja 30 tuba.
51. Sa sulfadiazinë keni?	Pa kufizim.
52. Ç'lloj sëmundje, që ka lidhje me aparatin e të marrurit frymë, bie më shumë ndër ushtarë?	Grip dhe plevit.
53. Ç'përqindje e ushtarëvet merr plevit?	Nuk e di përqindjen ekzakte. Ushtarët që kanë simptoma dëgjohen prapa vijavet të frontit. Spitali fushor ose ai i bazës ushtarake vendos në se ushtari e ka këtë sëmundje.
54. Sa për qind t'ushtarëvet kishin grip?	Kjo ndryshon. E mbaj në mend kur 50% t'ushtarëvet të Batalionit të 1-rë i kishte zënë gripi. Shumica e tyre u tërhoqën në spitalin fushor dhe kur u shëruan u kthyen përsëri ndër njësitë e tyre.
55. Sa për qind prej tyre nuk u shëruan?	Batalioni i 1-rë ka humbur 15 veta. Sasia e përgjithëshme e humbjevet nuk dihet.
56. A sëmuren shumë me bronkit?	Nuk kam mjekuar asnjë me bronkit.
57. Sa të sëmurë me polmonit ka pasur në muajin Janar?	Më duket tre dhe këta u dërguan në spitalin fushor.

58. Sa ushtarë janë të sëmurë me tuberkuloz?

Kisha për të thënë 30% të ushtarëvet kanë tuberkuloz ose plevit. Kur një ushtar ka simptoma prej ndonjërës nga këto sëmundje dërgohet në spitalin-bazë.

59. Cila sëmundje e zorrëvet është më e përhapura?

Dizinteria.

60. Sa për qind t'ushtarëvet e kanë këtë sëmundje?

Nja 5%. Ushtarët me dizinteri dërgohen në spitalin fushor. Ata me dizinteri të lehtë ose me të shkuar barku dërgohen në stacionin e shërbimit shëndetësor.

61. Sa ushtarë me të ftohur zorrësh janë mjekuar muajin e kaluar?

Asnjë.

62. Sa ushtarë kanë malarje?

Nja 40% t'ushtarëvet kanë pasur malarje, kush në një kohë, kush në një tjatër. Ata me malarje dërgohen në spitalin fushor ose n'atë të bazës.

63. Sa njerëz të sëmurë me "trichonozis" keni mjekuar?

Asnjë.

64. Kur keni mjekuar tifo ose tifo morri?

Asnjëherë nuk kam mjekuar njeri me tifo ose me tifo morri dhe as që kam dëgjuar të ketë pasur njerëz me sëmundje të tilla në divizion.

65. A ngrihen gjymtyrësh shumë njerëz?

Në këtë dimër kemi pasur pesë veta të ngrirë në ndonjë nga gjymtyrët, por dimrin që kaloi 50% t'ushtarëvet kanë pasur ngrirje të lehta ose të rënda.

LAJMËTARI

1. Ç'detyrë ke në Batalionin e 2-të?

Unë jam shoferi i zyrës së komunikimevet në Komandën e Batalionit.

2. D.m.th. ti shpie e merr me automobil personal, apo dorëzon komunikime?

Nganjëherë shpie marshallin ose adjutantin në ndonjë vend, por detyra ime kryesore është të kujdesohem që zyra e komukimevet të shpërndajë rregullisht postën e përditshme ose ndonjë komunikim të posaçëm që duhet të dërgohet jashtë.

3. A e bën dorëzimin e komunikimevet me automobil, apo vete edhe më këmbë?

Unë kam xhipin tim. Është shumë larg të vete më këmbë ndër komanda të ndryshme.

4. A u a dorëzon tërë postën komandavet?

Po, komandavet të kompanivet dhe komandës së regjimentit.

5. A janë këto komandat e taktikës që rrijnë përpara, apo janë komandat e prapavijavet?

Të tëra janë komanda taktike, përveç komandës së prapavijavet të Batalionit të 2-të.

6. Sa herë në ditë e shpërndan postën?

Zakonisht, një herë në ditë. Nganjëherë vete më shumë se një herë, kur ka ndonjë gjë me rëndësi për t'u dorëzuar, si skica ose raporte për rob lufte.

7. Kujt i drejtohen këto komunikime?

Ato të kompanivet i dorëzohen komandantit ose marshallit e ato të regjimentit përgjithërisht venë në S2 (sekcion i zyrës sekretë ushtarake, i një njësie që nuk ka shtab të përgjithëshëm) dhe në S3 (sekcion i operacionevet dhe i stërvitjevet, i një njësie që nuk

ka shtab të përgjithëshëm) ose i dorëzohen komandantit.

8. Ç'detyrë tjatër ke, përveç ngarjes s'automobilit?

Na'ën bëj rojë ose zëvendë- telefonistin. Shefi i rlidhjes më ka mësuar si të përdor radion dhe telefonin, kështu që tani vonë kam filluar të marr e të jap komuni'ime me radio.

9. Që të mund t'a përdorish radion, ti duhet të dijsh pseudonimet që përdorni në shifrar për njësitë e regjimentit tënd. Cili është pseudonimi i regjimentit tënd?

Është "Bulldog".

10. Cilat janë pseudonimet e regjimentit dhe të kompanivet të batalionit tënd?

Regjimenti ka pseudonimin "Blacksnake"; kompanitë dhe shtabet A, B, C, D janë: "Brillant", "Bermuda", "Bakery", "Boxer" dhe "Bumblebee".

11. Ku gjëndet komanda e batalionit tënd?

Është në gjysmë t'udhës në mes udhës kryesore të furnizimevet dhe vijës kryesore të qëndresës, pak si në përpjetë.

12. Kjo do të thotë se është në veri të rrugës që lidh depon e furnizimevet me komandën tënde të prapavijavet, apo jo?

Po, pothuaj nja 200 m. nga veriu.

13. Ku gjëndet komanda e regjimentit tënd?

Është lart në rrugën kryesore të furnizimevet nga veriu nja 1500 m. në të mëngjer të rrugës.

14. Në çfarë vendi (tereni) gjëndet komanda?

Është në një vend poshtë, në lindje të një vendi në mes dy majave të një mali që vete paralel me rrugën kryesore të furnizimevet.

15. A gjëndet komanda e vendosur ndër çadra, apo ndër ndërtesa të pabanuara? A është e fshehur apo e mbuluar që të mos shihet?

Është në një shtëpi fshati të vjetër prej guri, e cila është bombarduar shumë herë nga artileria. Nuk është e fshehur ose e mbuluar me gjëkafshë, por ka pemë afër.

16. A duhet të kalojsh ndonjë urë kur vete rrugës kryesore të furnizimevet ndërmjet batalionit dhe regjimentit?

Po, janë dy ura; njëra është nja 50 m. para se t'arrini në rrugën kryesore të furnizimevet dhe tjatra është pak para se të ktheheni në rrugën e komandës.

17. A janë këto ura druri, hekuri, çementoje apo barkash?

E para është urë barkash; e dyta ka hyrjet prej çementoje dhe është e shtruar me copa druri.

18. Ç'peshë mund të mbarin këto ura?

Nuk jam i sigurt, por e di se ura e barkavet nuk është mjaft e fortë për tanksa, sepse kam parë duke kaluar tanksa nëpër va në vend që të kalojnë nëpër urë. Ura tjatër është mjaft e madhe për çdo trafik; edhe topat tonë howitzer 8 in. kalojnë mbi të.

19. A është gjithënjë në gjendje të mirë rruga, apo ngelni në baltë kur bie shi?

S'kam ngelur kurrë në baltë, por me gjithë këtë kamionat 6 X 6 ngelin nganjëherë dhe duhet të nxiren nga balta; kjo ngjet afër batalionit. Në rrugën kryesore të furnizimevet s'ka ngatërresa as kur bie shi as kur ka diell.

SKUADRA E MORTAJAVET

1. Ti je ushtar Maslenikov. Thuamë se në ç'njësi je!

   Jam në Komapninë e 1-rë të Batalionit të 2-të të Regjimentit të 4-të Pushkatar të Divizionit të 1-rë Pushkatar të Rojevet.

2. Ç'detyrë ke në kompani?

   Jam ai që mbush.

3. Ç'do të thoni me fjalët "jam ai që mbush"? Ç'mbush? Në cilën skuadër je?

   Mbush mortajën dhe jam në skuadrën e mortajavet 82 mm.

4. Nga sa veta përbëhet skuadra jote dhe ç'detyrë ka secili?

   Përbëhet nga një kapter, që është kryetari i skuadrës, nga një rreshter, i cili është ai që gjuan, nga unë, që mbush mortajën dhe nga dy ushtarë, nga të cilët njëri mbar municion dhe tjatri e kalon dorë në dorë.

5. Nga sa njerëz përbëhet toga jote?

   Nga një oficer dhe 22 ushtarë.

6. Ç'bëjnë ushtarët tjerë të togës, d.m.th. ata që nuk janë në togën tënde?

   Ata janë mitraljerë të mitralozavet të rëndë.

7. Mortaja juaj është 82 mm., po sa e gjatë është tyta? A e ka tytën të lëmuet përbrenda?

   Tyta është e gjatë 48 in. dhe përbrenda është e lëmuet.

8. Si shtihet me të?

   Ka një gjilpërë të fiksuar dhe predha futet nga bishti, e cila zbrazet posa t'a përkasi gjilpërën.

9. Sa herë në minutë mund të shtihet me të dhe sa larg vret?

   Do të thonja se mund të shtihet 18 herë gjer në 20 herë në minutë. Vret nga 70 gjer në 3200 m.

10. Sa peshon?	134 lbs.
11. Sa mund të lëvizi djathtas e majtas dhe sa mund të ngrihet e t'ulet?	Mund të lëvizet djathtas e majtas 6 gradë dhe mund të ngrihet lart plus 45 gradë gjer plus 85 gradë.
12. Si e lëvizni nga një vend në një tjatër?	Zbërthehet tri copash, të cilat mbaren nga ushtarët. Kemi edhe ca rrota të cilat mund t'i a ngjisim. Zbërthehet tyta, dykëmbëshi dhe pllaka e bazës.
13. Sa peshon një predhë me eksploziv të fuqishëm?	Peshon nja 7.30 lbs.
14. Çfarë shenjestrash përdorni?	Tani jemi duke përdorur ca shenjestra panoramike, të cilat i kemi zënë si plaçkë lufte prej jush. Nuk e di ç'modeli dhe ç'marke janë.
15. Ç'bën kryetari i togës sate?	Vete poshtë e lart për të kontrolluar në se pozicionet tona janë të fshehura mirë dhe për të parë në se jemi të siguruar kundër çdo gjëje të papritur.
16. Ku është pozicioni i mortajës suaj?	Sot në mëngjes ishte gjithënjë në zonën e kompanisë. Nesër do të lëviznin në ca pozicione të reja në jug të kryqëzimit të rrugëvet.
17. Ku gjënden vëzhguesit tuaj që rrijnë përpara?	Tani janë në zonën e kompanisë në sektorin e shtabit.
18. Ç'ushqim ju japin?	Kemi pasur ushqim të mirë. Tani na japin gjëra të nxehta. Patate sa të duam, bukë dhe mish.

ORGANIZIM DHE PAJISJE

PJESA I

1. Si e keni emrin dhe ç'gradë keni?	Leg Pavlovitch Bartov, kapter.
2. Në ç'njësi jeni?	Jam në Togën e Mitralozavet Kundërajrorë të Kompanisë Antitanks dhe Kundërajrore.
3. Ç'detyrë keni në togë?	Jam nënoficeri politik i ngarkuar për stërvitje dhe propagandë politike.
4. Sa veta është e autorizuar të ketë toga?	Një oficer dhe 15 ushtarë.
5. Si është e organizuar toga?	Ka një sekcion shtabi dhe tri skuadra mitralozash kundërajrorë.
6. Përshkruanie sekcionin e shtabit?	Në sekcionin e shtabit ka një kryetar toge, i cili është toger, një kapter toge, një nënoficer politik, i cili është dhe një lajmëtar vëzhgues, i cili është ushtar.
7. Si përbëhet skuadra e mitralozavet kundërajrorë?	Çdo skuadër ka një kryetar toge, kapteri, një mitraljer, rreshteri, një ndihmës mitraljeri, i cili mbar edhe municion dhe është ushtar.
8. Sa mitraloza kundërajrorë ka toga?	Tre, një për çdo skuadër.
9. Përshkruanie këtë armë!	Është mitraloz i rëndë 12.7 mm., DShK, M 1938. Përdoret me [illegible]z, me rryp fishekësh dhe ftohet me ajr. Mund të rregullohet për qëlluar objektive në

tokë dhe n'ajr. Ka edhe rrota që i hiqen dhe i vihen.

10. Ç'karakteristika tjera ka arma?

Ka një shpejtësi predhe 2790 këmbë në sekondë. Vret vertikalisht 4950 këmbë dhe horizontalisht vret 2800 jardë larg. Është i gjatë 62.3 in.; peshon, me gjithë trekëmbësh dhe mburojë, 367.4 lbs.; shtie 125 herë në minutë dhe mund të sillet anash 360 gradë.

11. Çfarë mjete transportimi ka toga juaj?

Kemi vetëm një kamion 6 X 6, ZIS-1951.

12. Me çfarë armësh janë t'armatosur ata që bëjnë pjesë në togë?

Kryetari i togës dhe unë jemi t'armatosur me revole gjysmë automatike TT M1933; lajmëtar-vëzhguesi dhe të tjerët me pushkë automatike.

13. Ç'kalibër kanë ka secila nga këto armë?

Të tëra janë kalibër 7.62 mm.

14. Ju ishi i armatosur me një revole gjysmë automatike. Përshkruanie këtë armë më me hollësi!

Është "Tokarev" TT M1933 kalibër 7.62 mm. Fishekët i futen me dorë në vendin e posaçëm dhe përdoret me vegël zmbrapëse. Shpejtësia e plumbit është 1378 këmbë në sekondë; vret gjer në 50 jardë. Peshon pa fishekë 1.8 lbs. dhe zë 8 fishekë.

15. Tani më përshkruani pushkën automatike!

Quhet "Mossin-Nagant", model M 1944. Përdoret me rryp fishekësh dhe me krehër. Shpejtësia e plumbit është 2650 këmbë në sekondë; vret 440 jardë larg dhe shtie nga 8 gjer në 10 herë në minutë. Arma pa fishekë peshon 8.82 lbs. Është e gjatë 40 in. dhe zë 5 fishekë.

16. A ka sigurecë kjo armë?

Kur futet fisheku dhe mbyllet shuli, arma vihet në sigurecë duke e ngrehur sigurecën prapa dhe duke e sjellur nga e majta gjer ku të shkojë.

17. A ka bajonetë kjo armë?

Ka një bajonetë të fiksuar në tytë, e cila mbështillet më të djathtë t'armës kur nuk përdoret.

ORGANIZIM DHE PAJISJE

PJESA II

18. Në cilën njësi jeni, Zoti Toger Kuznetov?	Jam në Togën e 1-rë të Kompanisë së Mortajavet 120 mm. të Regjimentit të 96-të Pushkatar.
19. Ç'pozitë keni në togë?	Jam kryetari i togës.
20. Si është e formuar toga juaj?	Ka një sekcion shtabi dhe dy skuadra mortajash 120 mm.
21. Sa personel ju lejohet të keni në sekcionin e shtabit nga kuadri i Organizimit dhe i Pajisjes?	Një toger si kryetar toge, një kapter si kapter toge, një kapter si nënoficer politik dhe një ushtar si lajmëtar-vëzhgues.
22. Sa njerëz ka çdo skuadër dhe ç'detyrë ka secili?	Secila prej dy skuadrave përbëhet nga një kapter si kryetar toge, nga një rreshter që zbraz mortajën, nga një ushtar që mbush mortajën, nga një ushtar tjatër që e kalon municionin dhe nga tre ushtarë që mbarin municion.
23. Sa mortaja ka në togën tuaj?	Dy, një për çdo skuadër.
24. Ç'kalibri dhe ç'modeli është kjo mortajë?	Është 120 mm., model M1938.
25. Ç'karakteristika tjera ka kjo armë?	Predha shkon me një shpejtësi 890 këmbësh në sekondë dhe vret 438 gjer në 6564 jardë. Mortaja mund të sillet anash plus ose minus 3 gradë; gjatësia e tytës është 60.5 in.; mund të çohet nga plus 45 gradë gjer në plus 80 gradë. Kur është në lëvizje peshon 1081 lbs.

26. Ç'tjatër mund të më thoni për këtë armë?	Lëvizet me shumë lehtësi, pasi në krahasim me madhësinë që ka është e lehtë. Ka një lloj karroce dy rrotash për transportim, e cila i ngjitet lehtësisht mortajës. Ka edhe pllakën e rrumbullaktë të bazës, të lehtë. Në rast se duhet të transportohet, zbërthehet në tri pjesë. Në rast se duhet të tërhiqet me kafshë ose me automjet, shpesh i vihet një karrocë e madhe me dy rrota. Mortaja mund të zbrazet me të hudhur të predhës ose me këmbëz.
27. Ç'mjete transportimi ka toga juaj?	Ka dy kamiona 6 X 6, ZIS-1951.
28. Bëni një përshkrim më të gjerë të këtyre kamionave!	Kanë karoceri të hapta dhe kanë motor gjashtë cilindrash që punon me benzinë, që ftohet me ujë. Kanë nga gjashtë rrota që tërheqin pasvarësisht nga njëra tjatra dhe këta kamiona përdoren për të transportuar si topa ashtu edhe material dhe njerëz.
29. Sa është largësia në mes rrotavet dhe sa mbar kamioni?	Largësia në mes rrotavet është 165 in. dhe mbar katër tona e gjysmë.
30. Me ç'armë janë t'armatosur njerzit e togës?	Nënoficeri politik dhe unë mbajmë revole. Kapteri i togës, kryetarët e skuadravet dhe lajmëtar-vëzhguesi mbajnë pushkë automatike. Ata që mbushin mortajën dhe ata që e kalojnë dorë në dorë municionin mbajnë pushkë automatike, kurse ata që e zbrazin mortajën dhe ata që mbarin municion janë t'armatosur me pushkë.

31. Tani, Zoti Toger, dua që të më bëni një përshkrim të pushkës që mbajnë ata që zbrazin mortajat dhe mbarin municionin?

Pushka quhet "Tokarev" dhe është model M 1940. Përdoret me gaz dhe me krehër; është gjysmë automatike. Vendi ku futen fishekët -së 10 fishekë- është në formë kutie dhe krehri me fishekë futet në fund të vendit ku i merr fishekët. Mund të futen edhe përsipër këtij vendi dy krehre pesë fishekësh.

32. Më tregoni peshën, shpejtësinë e plumbit, sa larg qëllon etj.!

Shpejtësia e plumbit është 2730 këmbë në sekondë. Qëllon 440 jardë larg. Peshon 86 lbs. pa fishekë dhe është e gjatë 48.2 in. Shtie 20 gjer në 225 herë në minutë.

33. Ç'shenjestra dhe ç'sigurecë ka kjo armë?

Ka dy shenjestra: një përpara në formë tehi, e fiksuar dhe një prapa tangjënt "V", e cila është shkallëzuar nga 100 gjer në 1500 m. Pushka vihet në sigurecë duke e shtyrë sigurecën gjer sa t'a blokojë lëvizjen që bën nga prapa këmbëza.

34. Si është e formuar pjesa tjatër e kompanisë?

Kompania ka një sekcion shtabi dhe tri toga mortajash. Togat janë të tëra njëlloj si ajo në të cilën bëj pjesë unë.

35. Sa është forca e përgjithëshme e kompanisë suaj?

Pesë oficerë dhe 59 ushtarë.

ORGANIZIM DHE PAJISJE

PJESA III

36. Zoti Kapiten Volkov, dua që të më thoni diçka mbi njësinë në të cilën bënit pjesë: mbi Armatën e 9-të të Rojevet. Prej ç'divizionash përbëhet kjo armatë?

Përbëhet prej divizionit të 91-të të Mekanizuar të Rojevet, prej Divizionit të 77-të të Tanksavet, prej Divizionit të 25-të Pushkatar dhe prej Divizionit të 5-të t'Artilerisë.

37. Ç'regjimente dhe ç'batalione më vete janë me armatën?

Vetëm Regjimenti i 941-të i Xhenios.

38. Çfarë njësie është kjo?

Është Regjimenti për Ndërtimin e Urave të Mëdhaja.

39. Ç'njësi bëjnë pjesë në Divizionin e 91-të të Mekanizuar të Rojevet?

Në Regjimentin e Mekanizuar bëjnë pjesë: i 23-ti, i 24-ti dhe i 25-ti; Regjimenti i 220-të i Tanksavet Mesatarë, Regjimenti i 721-të i Artilerisë së Tanksavet të Rëndë me motor dhe Divizioni i Artilerisë.

40. Nga ç'njësi përbëhet Divizioni i 77-të i Tanksavet?

Përbëhet nga Regjimentet e Tanksavet Mesatarë 101, 706 dhe 708; nga Regjimenti i 707-të i Artilerisë së Tanksavet të Rëndë me motor, nga Regjimenti i 7-të Pushkatar i Motorizuar dhe nga Divizioni i Artilerisë.

41. Vazhdoni me Regjimentin e 25-të Pushkatar!

Regjimenti i 25-të Pushkatar ka Regjimentet Pushkatarë 81, 82 dhe 84; Regjimentin e 125-të të Tanksavet me motor dhe një brigadë artilerie.

42. Tani më thoni cili është organizimi i Divizionit të 5-të t'Artilerisë!

Nuk e di se ç'njësi përfshin Divizioni i 5-të i Artilerisë, por di se përveç njësivet që bëjnë pjesë n'organikën e Divizionit, Komandanti i Përgjithëshëm komandon edhe artilerinë e tri divizioneve tjera: atë të Divizionit të 91-të të Mekanizuar të Rojevet, atë të Divizionit të 77-të të Tanksavet dhe atë të Divizionit të 25-të Pushkatar. Natyrisht, kjo është vetëm për këtë operacion.

43. Çfarë armësh ka Divizioni i 5-të i Artilerisë? Flas për armët organike.

Nuk di shumë mbi Divizionin e Artilerisë, por di se kanë disa bazuka 132 mm., disa topa howitzer 152 mm. dhe disa topa 122 mm.

44. Janë tri regjimente të mekanizuar në Divizionin e 91-të të Mekanizuar të Rojevet. Ç'forcë kanë këto tri regjimente?

Secili nga regjimentet e mekanizuar ka dy bataliona pushkatarë të motorizuar, një batalion tanksash mesatarë, një batalion artilerie dhe një batalion mortajash. Kanë gjithashtu, një kompani vëzhguese, një bateri kundërajrore, një kompani sinjalesh, një kompani xhenioje dhe pak trupa për shërbim.

45. Divizioni i Mekanizuar i Rojevet ka edhe një regjiment tanksash mesatarë. Si është i organizuar ky regjiment?

Ka tre bataliona tanksash mesatarë, një batalion pushkatar të motorizuar, një kompani mitralozash kundërajrorë dhe pak trupa për shërbim.

46. Si është i formuar Regjimenti i Tanksavet të Rëndë me motor?

Ka dy bataliona tanksash të rëndë, një batalion artilerie të rëndë me motor, një batalion të motorizuar mitralozash dore, një kompani vëzhguese, një kompani kundërajrore dhe një togë sinjalesh.

47. Ç'njësi përfshin artileria e Divizionit të Mekanizuar?

Ka një regjiment topash howitzer 122 mm., një regjiment mortajash 120 mm., një batalion bazukash 132 mm.

48. Si janë t'organizuar Batalioni Pushkatar i Motorizuar dhe Regjimenti i Mekanizuar?

Janë t'organizuar në bazë tri njësishë me tri kompani pushkatare secili. Mbrojtja e brendshme bëhet nga një kompani mitralozash të rëndë me gjashtë mitraloza 7.62 mm.; nga një kompani mortajash me 6 mortaja 82 mm. dhe nga një kompani antitanks e pajisur me 4 topa antitanks 57 mm. Përveç këtyre ka edhe një togë sinjalesh si edhe një njësi të vogël për shëndetësi dhe për shërbime të ndryshme.

49. Shumë mirë. Tani më tregoni mbi organizimin e Batalionit të Tanksavet Mesatarë të të njëjtit regjiment!

Ka një sekcion shtabi të batalionit me një kompani tanksash mesatarë dhe me dy kompani tanksash. Çdo kompani tanksash ka një shtab me një tanks mesatar dhe tri toga tanksash me tre tanksa mesatarë secila.

50. Ka edhe dy batalione në regjiment: Batalioni i Artilerisë dhe Batalioni i Mortajavet. Më tregoni se si është i formuar Batalioni i Artilerisë!

Të vetmen gjë që di mbi Batalionin e Artilerisë është se ka 12 topa 76 mm. Nuk e di si është i organizuar.

51. Më thoni se si është i organizuar Batalioni i Mortajavet!

As këtë s'e di si është i organizuar. Di vetëm se ka 6 mortaja 120 mm. dhe 12 mortaja 82 mm.

52. Është edhe një njësi tjatër e Regjimentit të Mekanizuar, për të cilën dua që të më thoni diçka: mbi kompaninë vëzhguese. Si është e organizuar?

Të vetmen gjë që di mbi kompaninë vëzhguese është se është e pajisur me autoblinda dhe me kamiona për transportim trupash.

53. Ç'tjatër mund të më thoni mbi Divizionin e Mekanizuar?

Di se roli taktik kryesor i Divizionit të Mekanizuar është të ndjekë armikun dhe të çfrytëzojë situata në lidhje me fuqitë e tanksavet. Divizioni është në gjendje të bëjë edhe mësymje të pavarura dhe të kryejë misione kundër pozicionevet mbrojtëse t'armikut, të dobta ose të demoralizuara.

ORGANIZIM DHE PAJISJE

PJESA IV

54. Zoti Kapiten Viklov, jam kalorës i vjetër dhe si i tillë interesohem gjithënjë për njësi të mobilizuara dhe për ato me kuaj. Kam marrë vesh se keni edhe tash një numër njësishë kalorije me kuaj.

Po, kemi një numër divizionesh kalorie dhe pak korparmata kalorie.

55. Si është e organizuar korparmata e kalorisë?

Korparmata ka një forcë prej 19.000 vetash. Ka tri divizione kalorie dhe armë ndihmëse, të cilat përshijnë një sasi të madhe mjetesh të koracuara, artileri që duhet të tërhiqet me mjete tjera, artileri të motorizuar, trupa speciale dhe trupa për shërbime të ndryshme.

56. Sa është forca e divizionit të kalorisë?

Ka një forcë prej 4650 vetash dhe 4600 kuajsh.

57. Si është i organizuar divizioni i kalorisë?

Kuadri i tij përfshin tri regjimente kalorie: një regjiment të përzier me artileri të lehtë dhe me mortaja të rënda, një regjiment të vogël vëzhgues sinjalesh, xhenioje, antiajror dhe një regjiment me njësi shërbimesh të ndryshme.

58. A është divizioni i kalorisë i caktuar të veprojë si pjesë e pandarë e një korparmate, apo mund të veprojë edhe më vete?

Divizioni i kalorisë është i organizuar në mënyrë që mund të veprojë si më vete ashtu edhe si pjesë e pandarë e korparmatës së fuqishme të kalorisë. Është një njësi e pajisur vetëm

	me kuaj, pa automjete, përveç kolonavet të municionit dhe të furnizimevet, të cilat kanë automjete.
59. Sa është forca e regjimentit të kalorisë?	Secili regjiment ka 1140 oficerë dhe ushtarë dhe 1180 kuaj.
60. Si janë t'organizuar?	Ka një shtab të regjimentit, 4 bataliona kalorie, një batalion mitralozash, një batalion mortajash, një bateri topash howitzer, një bateri kundërajrore dhe pak trupa për shërbime të ndryshme.
61. Cilat janë armët kryesore të regjimentit?	Ka 4 topa howitzer 76 mm., 4 topa antitanks 75 mm., 12 mortaja 82 mm., 3 mitraloza kundërajrorë, 16 mitraloza të rëndë dhe 43 mitraloza të lehtë.
62. Sa automjete ka regjimenti?	Ka 115 mjete transportimi që tërhiqen me kuaj dhe 3 automjete.
63. Interesohem edhe për Divizionin tuaj Pushkatar. Sa është forca e këtij divizioni?	Ka afro 11.000 oficerë dhe ushtarë.
64. Si është i organizuar?	Ka afro tri regjimente pushkatare.
65. Ç'armë ndihmëse ka në divizion?	Ka një brigadë artilerie me 24 topa 76.2 mm., 36 topa howitzer 122 mm. dhe 12 mortaja 16 mm. Ka një regjiment të përzier me 52 tanksa mesatarë me topa 85 mm., 16 topa 100 mm. me motor. Ka një batalion antitanks me 12 topa 85 mm. pa motor, d.m.th. që duhet të tërhiqen nga një mjet tjatër. Ka edhe një batalion vëzhgues, një batalion sinjalesh, një batalion

xhenioje dhe një batalion kundërajror. Ka gjithashtu edhe një kompani të vogël mbrojtëse kundër mjetevet kimike.

66. Po trupa për shërbime të ndryshme, a keni?

Nën kuadrin e prapavijavet janë të grupuar: një batalion shëndetësie, një batalion kamionash transportues, një njësi intendence dhe mirëmbajtje dhe një skuadër e vogël prej tre aeroplanash të lehtë ndërlidhës.

67. Si janë t'organizuara regjimentet pushkatare?

Regjimenti ka tre batalionа pushkatarë, artileri regjimenti, togë kundërajrore, një kompani sinjalesh, një togë xhenioje dhe pak trupa për shërbime të ndryshme.

68. Ju përmendët artileri regjimenti. Si është e formuar?

Përbëhet nga një kompani kundërtanksash me 6 topa antitanks 57 mm., nga një kompani artilerie të motorizuar me 6 topa me motor 76 mm. dhe prej një kompanie mortajash me 6 mortaja 120 mm.

69. Si janë t'organizuar batalionat pushkatarë?

Secili ka nga tri kompani pushkatare dhe një togë mitralozash të vegjël. Secila nga tri togat pushkatare prej 30 vetash është e formuar prej tri skuadrash me një oficer dhe dy ushtarë në komandën e togës.

ORGANIZIM DHE PAJISJE

PJESA V

71. Si e keni emrin dhe ç'gradë keni?	Ivan Boris Papov; jam toger.
72. Në ç'njësi jeni?	Jam në kompaninë e 1-rë Pushkatare të Batalionit të 3-të të Divizionit të 3-të.
73. Sa është forca e kompanisë suaj, sipas kuadrit?	Ka një forcë prej 6 oficerësh dhe 127 ushtarësh.
74. Si është e përbërë kompania juaj?	Kompania ka një sekcion shtabi me 2 oficerë dhe 6 ushtarë, tri toga pushkatare me një oficer dhe 33 ushtarë secila dhe një togë armësh me një oficer dhe 22 ushtarë.
75. Ç'gradë dhe ç'detyrë kanë ata që janë në sekcionin e shtabit?	Një është kapiten, komandant kompanie; një toger, oficer politik; një marshall; një kapter me shërbim në mensë; një tjatër kapter i furnizimevet; një rreshter si kopist dhe dy ushtarë, të cilët janë shpërndas letrash.
76. A janë kështu edhe togat pushkatare?	Po.
77. Si është i organizuar personeli në një togë pushkatarësh?	Ka një sekcion shtabi me një oficer dhe 3 ushtarë dhe tri skuadra pushkatarësh me 10 ushtarë secila.
78. Ç'gradë dhe ç'detyrë kanë ata që janë në sekcionin e shtabit të togës?	Ka një toger si kryetar toge, një kapter si kapter politik, një kapter si kapter toge dhe një ushtar si lajmëtar vëzhgues.

79. Mirë. Tani më tregoni të njëjtën gjë për sa u përket atyre që e përbëjnë skuadrën e pushkatarëvet!

Skuadrat e pushkatarëvet janë po ashtu. Në secilën prej tyre ka: një kapter si kryetar skuadre, dy rreshterë si mitraljerë për mitraloza të lehtë, dy ushtarë si ndihmës mitraljerë për mitraloza të lehtë dhe pesë ushtarë si pushkatarë.

80. Më tregoni ç'dini mbi togën e armëvet!

Toga e armëvet përbëhet nga një komandë toge, nga tri skuadra mitralozash të rëndë dhe nga një skuadër mitralozash të lehtë.

81. Si është i përbërë shtabi i togës?

Përbëhet nga një toger si kryetar toge, nga një kapter si kapter toge dhe nga një tjatër si kapter politik.

82. A janë t'organizuara në të njëjtën mënyrë skuadrat e mitralozavet të rëndë?

Secila nga skuadrat e mitralozavet të rëndë ka një kapter si kryetar skuadre, një rreshter si mitraljer, një ushtar si ndihmës mitraljeri dhe dy ushtarë që mbarin municion.

83. M'a përshkruani në të njëjtën mënyrë skuadrën e mortajavet 82 mm.!

Ka një kapter si kryetar skuadre, një rreshter që shtie, një ushtar që udhëheq dhe dy ushtarë që mbarin municion.

84. Ç'detyrë kishit në kompani?

Komandoja togën e armëvet.

85. Në togën tuaj kishte tri skuadra mitralozash. Sa mitraloza kishte çdo skuadër?

Një për çdo skuadër.

86. M'epni hollësi mbi këtë mitraloz!

Është një mitraloz i rëndë 7.62 mm., M 1943 "Goryunov". Ky mitraloz i rëndë përdoret me gaz, ftohet me ajr, shpejtësia e plumbit është

2620 këmbë në sekondë, vret për tokë në një largësi prej 1100 jardësh dhe si armë kundërajrore vret 1550 këmbë larg. Është i gjatë 46 in. dhe mund të shtihet me të nga 300 gjer në 350 herë në minutë.

87. Sa peshon ky mitraloz?

Mitralozi peshon nja 60 lbs. dhe trekëmbëshi peshon nja 30 lbs.

88. M'a përshkruani trekëmbëshin!

Është trekëmbësh "Universal M 1931" i përmirësuar, i cili sillet kollaj si mbështetës për të shtira kundërajrore.

89. Çfarë rryp fishekësh përdoret për këtë armë?

Mund të përdoret rryp stofe me 250 fishekë M 1910 ose rryp metali me 50 fishekë. Rrypi i metalit mund të bashkohet me katër të tjerë për t'u bërë kështu 250 fishekësh. Çdo municion rus për pushkë 7.62 milimetrash mund të përdoret me këtë mitraloz.

90. M'a përshkruani sigurecën e kësaj arme!

Ka dorëza në formë të shkronjës D dhe një vegël në formë pjate.

KRYETAR PATRULLE

1. Si e keni emrin dhe ç'gradë keni?	Dimitri Nanovich Svedlov, kapter.
2. Në ç'njësi jeni?	Jam në Skuadrën e 1-rë të Togës së 1-rë të Kompanisë së 1-rë Pushkatare të Regjimentit të 4-të Pushkatar të Divizionit të 1-rë Pushkatar të Rojevet.
3. Ç'detyrë keni në kompani?	Jam kryetari i Skuadrës së 1-rë.
4. Sa ushtarë keni në skuadër?	Skuadra përbëhet nga unë dhe nga një grup njerzish që nevojiten për mitralozin e lehtë. Ky grup përbëhet nga një rreshter dhe një ushtar tjatër, i cili shtie në pusi (snajper) dhe nga 5 pushkatarë.
5. Ç'[illegible] ë mba secili?	Unë mbaj pushkë; gjithashtu edhe pushkatarët dhe ushtari që shtie fshehurazi (snajperi). Mitraljerët mbajnë pushkë automatike.
6. Ç'modeli është pushka juaj?	Është pushkë gjysmë automatike, M 1940 "Tokarev", 7.62 mm.
7. M'a përshkruani pushkën: sa peshon, sa është e gjatë, sa fishekë merr, si përdoret, sa larg qëllon dhe sa është largësia m'e madhe që mund t'arrijë plumbi!	Është pushkë që përdoret me karikator 10 fishekësh; shpejtësia e plumbit është 2720 këmbë në sekondë; qëllon 407 m. larg; do të thonja se është e gjatë 48 inç; peshon 8.5 lbs. Mund të shtihet me këtë pushkë 20 herë në minutë.

8. Ç'model dhe ç'lloj pushke automatike mbajnë ushtarët tjerë?

Di vetëm se janë pushkë automatike PPS-1943 dhe punojnë me të njëjtin municion të pushkëvet tona.

9. Pasi ju ishit kryetari i patrullës, më tregoni ç'mision kishit?

Më thanë të zbuloja se ku i kishit vendosur telat me gjëmba, pozicionet e mitralozavet, të mortajavet dhe vendin e pushkatarëvet tuaj në zonën e batalionit tonë. Më thanë se skuadra ime që m'e mira dhe kjo që arësyeja që vajtëm ne. Këto informata më thanë se lypseshin për një sulm që do të bëhesh.

10. A i dini shenjat konvencionale të hartavet?

Besoj se po, në qoftë se janë të vizatuara si ato që na i kanë dhënë neve.

11. Mirë. Pasi kjo hartë nuk është tamam si skicat tuaja, m'a përshkruani vetëm terenin duke filluar nga vendi ku u zutë rob e gjer në kompaninë tuaj. Ky është vendi ku u zutë rob; atje është një kodër e vogël me pemë, tamam në veri pothuaj 50 m. nga përroi ku ju zunë. Ç'rrugë muarët për t'arritur ke përroi?

I zbritëm një tatëpjetë me pemë nga perëndimi i asaj kodre. Arritëm në këtë tatëpjetë pothuaj 500 m. nga veriu i kodrës pasi kalum nëpër pyll nga veriperëndimi. Besoj se pylli ishte 2 km. i gjërë. U futëm në pyll nga një rrugë e shtruar, e cila shkon nga veriu dhe nga jugu. Vendi prej nga u nisëm ishte 500 m. në veri të një kryqëzim rrugësh -në një pyll në veri gjatë kësaj rruge- Këto rrugë në vendin ku kryqëzohen janë të shtruara.

12. Ç'trupa keni parë n'atë rrugë duke u nisur nga komanda juaj?

Aty ku kryqëzohen rrugët kam parë dy mitraloza të rëndë.

13. Të cilës njësi ishin?

Ishin mitraloza të rëndë të njësisë sonë.

14. Sa ushtarë kishte me mitralozat?

E tërë skuadra e mitralozavet: pesë ushtarë.

15. Si janë të vendosur mitralozat?

Janë nder gropa, të drejtuar nga jugu; desha të thonja se njëri nga mitralozat është në gropë; tjatri nuk është.

16. M'i trego pozicionet e tyre! Ku ishin nga vendi ku kryqëzohen rrugët?

Njëri ishte në skaj, nga verilindja e buzës së pyllit, 10 metra nga kryqëzimi i rrugëvet; tjatri ishte në qoshe nga veriperëndimi, pothuaj 5 metra nga kryqëzimi i rrugëvet, përpara një shkëmbi të madh me disa trupa pemësh përpara tij.

17. Ç'njësi tjera keni parë?

S'kam parë ndonjë njësi tjatër.

18. Ç'parullë e ç'kundërparullë kishit?

"Stalin" dhe "Malenkov".

19. Ç'rrugë do të merrshit për t'u kthyer në komandën tuaj?

Çfarëdo rruge që të mendonja se mund të më shpiente në komandë, përveç asaj nëpër të cilën erdhëm.

20. Si quhej njeriu që ju mori në pyetje?

Më duket, Kapiten Tyumenko. Kapiten Gorloff, komandanti i kompanisë sanë, më tha se ay ishte oficeri i shërbimit të fshehtë të batalionit.

21. Ku gjëndet komanda e batalionit?

Nuk e di. Kam dëgjuar kapterin duke thënë se komanda e batalionit gjëndej në veri të komandës sanë dhe në veri të rrugës së tij.

ANËTAR PATRULLE

1. Si të quajnë dhe ç'gradë ke?	Petro Dormesky, ushtar.
2. Në ç'njësi je?	Jam në skuadrën e 1-rë të Togës së 1-rë të Kompanisë së 1-rë Pushkatare të Batalionit të 2-të të Regjimentit të 4-të Pushkatar të Divizionit të 1-rë Pushkatar të Rojevet.
3. Ç'detyrë ke në kompani?	Jam vetëm pushkatar.
4. Ç'punë bënje para se të hynje n'ushtri?	Kam qenë bujk. Kam punuar në një fermë kolektive.
5. Sa shkollë ke bërë?	Katër vjet, në qytetin Rommee.
6. Ti ishe një nga pushkatarët e Skuadrës së 1-rë dhe ti ishe në këtë patrullë. Më trego nga e fillove patrullën!	Patrullën e filluam sot në mëngjes n'orën 5 nga komanda e kompanisë.
7. Ku gjëndet komanda e kompanisë sate?	Në veri të vendit ku jemi.
8. A i di shenjat konvecionale të hartavet?	Jo.
9. Ti the se komanda e kompanisë sate është në veri të vendit ku jeni; sa larg është?	E di se është në veri të vendit ku ndodhemi sepse është në veri të një kryqëzim rrugësh dhe ne erdhëm nga jugu i atij kryqëzimi para se të na zinin.
10. Sa larg nga veriu i kryqëzimit të rrugëvet?	0, besoj të jetë 450 çapa nga veriu. E di se është në një pyll, jashtë rrugës së shtruar.

11. Si e di se është 450 çapa?

E kam matur kot, duke mejtuar se do të kishte qenë mirë sikur t'ishte toka ime.

12. Ç'lloj arme kishe?

Si atë të kapteravet: pushkë gjysmë automatike 7.62 mm. Pushka ime është "Tokarev", dhe në kondak të saj kam gdhendur me thikë emrin Olga.

13. M'ep hollësira mbi këtë armë: ç'gjatësi ka, sa peshon dhe sa fishekë zë!

Nuk di shumë gjëra mbi këtë pushkë; di vetëm që zë 10 fishekë dhe se peshon afro 8½ lbs.

14. Nga sa veta përbëhet skuadra jote?

Pa të mejtohem një çikë. Përbëhet nga kapteri, nga dy mitraljerë, nga ay që shtie në pusi (snajperi) dhe nga pesë pushkatarë. Sa njerëz gjithësejt?

15. Sa toga ka kompania jote?

Nuk e di; kapteri ka thënë se ka tri toga pushkatarësh dhe një togë armësh. Na ka thënë edhe se s'duhej të bëheshim merak për togat tjera të pushkatarëvet sepse ishin njëlloj si tonat.

16. Ç'njësi ke parë kur ishe në patrullë?

Mitralozat tonë të rëndë.

17. Ku?

Mu afër kryqëzimit të rrugëvet, në jug të komandës së kompanisë sonë.

18. Ç'rrugë more dhe sa larg vajte kur e kalove kryqëzimin e rrugëvet?

Vajtëm nga jugu për pothuaj 1 km. dhe pastaj u futëm në pyll; në pyll ecëm në drejtim të juglindjes gjer në një tatëpjetë dhe pasi zbritëm arritëm në një kodër. Më zutë kur isha duke i u ngjitur kodrës për të parë në se mund të shifja s'andejmi ndonjë nga pozicionet tuaja.

19. Si e ka emrin komandanti i kompanisë sate?

Kapiten Gorloff.

20. Si quhet dhe ç'gradë ka njeriu që të mori në pyetje?

Kapteri më tha se quhej Tumenko dhe se ishte kapiten. E dëgjova duke thënë se ne ishim zgjedhur pasi ishim "skuadra m'e mirë" dhe se do t'ishim shumë të dobishëm për mësymjen që do të bëhet nesër.

21. Ku i keni të vendosura mortajat?

Nuk e di. Dëgjova se do t'i lëviznin sonte afro 100 m. nga jugu i kryqëzimit të rrugëvet dhe të mitralozavet tonë. Kështu më tha mitraljeri, me të cilin kemi qenë në shkollë tok; është rreshter dhe quhet Papov.

22. Nga sa veta përbëhet kjo njësi mortajash?

Ka një kapter, një që shtie me mortajë, shoku im rreshteri, një që e mbush, një që e kalon municionin dorë më dorë dhe që është municion mbartës. Këta të fundit besoj të jenë ushtarë të thjeshtë.

23. Çfarë njësishë ndihmon kjo njësi mortajash?

O, bëjnë pjesë me kompaninë tonë.

24. Ç'parullë ose ç'shenjë do të përdoroje për t'u kthyer në kompaninë tënde?

Nuk ka shenja, por ne do të thonim "Malenkov" në qoftë se roja do të na thonte "Stalin".

RADISTI (RADIOTELEGRAFISTI)

1. Ç'detyrë kishit në Kompaninë e Mortajavet të Rënda të Regjimentit të 666-të të Këmbësorisë?

   Isha radist në Qendrën e Rregullimit të Qitjes së Kompanisë.

2. Ku gjëndej Qendra e Rregullimit të Qitjes?

   Në rrëzë të kodrës 477 nga jugu.

3. Dje, kur trupat tona sulmuan, a ishi duke u marrë me kërkesat për qitje të vëzhguesvet që rrijnë përpara?

   Po, por pasi vija telefonike u këput nga të shtirat e artilerisë, na u desh të bazoheshim kërkesisht në radio.

4. Sa vëzhgues që rrijnë përpara kishte kompania jashtë, kur filloi sulmi?

   Kishim tre, një për çdo sektor të batalionit të pushkatarëvet.

5. A ishin që të trija togat tuaja në pozicion n'atë kohë?

   Sigurisht, dhe qëllonin pa pushuar.

6. Sa mortaja në gjëndje të mirë kishte çdo togë?

   Çdo togë, përveç Togës së 3-të, kishte nga katër tyta. Toga e 3-të kishte një tytë të plasur dhe kishte humbur një tytë dhe katër njerëz.

7. Si i dërgonit mesazhet, me shenja e shifra, apo të hapura?

   Të tëra ishin të hapura, përveç koordinatavet të hartës. Për këto kemi përdorur shifra koordinatash për harta.

8. Sa shpesh i ndërroni shifrat e koordinatavet të hartavet?

   Çdo tri dit, me përjashtim kur marrim vesh se i keni zbuluar ose kur kemi dyshim se muni të jenë zbuluar.

9. Kur duhet të ndërrohen shifrat herën tjatër?

   Sot në mëngjes n'orën 6. Shifrat e reja nuk i di.

10. Ç'lloj radioje kishit në përdorim dje?

Një radio që s'është m'e mira në botë: AN/PRC-10.

11. Është radio me valë AM, apo FM?

Është radio FM, por n'ato kodra nuk dëgjohet përhera mirë.

12. Ku gjëndet shtabi i kompanisë suaj?

Mu afër komandës së regjimentit, pothuaj 1000 m. larg.

13. Sa nga radiot që thatë keni në përdorim në kompani?

Kemi 10 dhe një tjatër AN/GRC-7; më duket se kemi edhe një AN/GRC-9.

14. Ku gjënden togat tuaja (të zjarrit)?

Nuk kam qenë asnjëherë në ndonjë nga pozicionet, por e di se të tëra janë poshtë tatëpjetës që ndodhet prapa vijës së qëndresës së regjimentit. Komandanti ka thënë se janë aq afër, sa edhe 60 milimetërshi juaj mund të na qëllonte po t'a dinit se ku ishim.

15. Ç'lloj vije telefonike keni në mes qendrës së rregullimit të qitjes dhe vëzhguesvet që rrijnë përpara?

Kemi vijë të dyfishtë. Ka lidhje direkte që shkon gjer ke vëzhguesit që rrijnë përpara dhe lidhje që shkon gjer ke batalionat e pushkatarëvet, kështu që njësitë e armëvet të rënda mund të telefonojnë drejt për drejt duke kërkuar autorizim për qitje. Të shumën e herës, vëzhguesit tonë që rrijnë përpara kanë edhe një lidhje ndihmëse, që shkon gjer ke batalioni, të cilit janë duke i ndihmuar.

16. Sa municion kishte kompania pas sulmit?

Na mungonte pothuaj çdo lloj municioni, përveç fosforit të bardhë. E mbaj në mend oficerin artiljer duke thënë se vetëm Togës së 1-rë i kishin mbetur ca predha me eksploziv të fuqishëm e ca raketa.

17. Sa larg qëllon mortaja 4.2 që keni në përdorim tani?

Qëllon gjer në 6000 jardë, por komandanti ka thënë se s'duhet të shtiem më larg se 5500 jardë, me përjashtim kur artileria s'e bën dot.

18. A ka bërë ndonjë efekt koha e keqe në radion tuaj, d.m.th. a merrte mirë?

Ndër vija të shkurtëra telefonike, gjer në dy mila largësi, kur folësit e shofin njëri tjatrin, koha e keqe s'prish punë. Por në rast se toka ndërmjet dhënësit dhe marrësit është brigje-brigje, ahere e humbin kontaktin gjer sa të pushojë stuhia.

19. Ç'njësi artilerie keni parë në zonën e regjimentit tuaj?

Jo shumë larg nga komanda e regjimentit është një njësi pushkatarësh e përbërë nga 155 veta, pothuaj një bateri; s'kam parë tjatër. Batalioni i 1-rë Fushor duhet të jetë afër, pasi na kanë dhënë ndihmë direkte shumë herë. Besoj se njësia e pushkatarëvet që thash më parë i jep ndihmë të plotë divizionit, ndofta edhe korparmatës.

VËZHGIM

1. Ç'mision kishit kur u zutë rob, Zoti Kapter?	Isha duke kontrolluar rrugët, për të parë në se ishin të përshtatshme për tanksa.
2. Në ç'kompani të Batalionit të 319-të të vëzhgimit bëni pjesë?	Në Kompaninë e Tanksavet të Mesëm.
3. Ç'detyrë keni në këtë njësi?	Komandant tanksi.
4. Sa oficerë dhe sa ushtarë ka kompania?	Katër oficerë dhe 65 ushtarë.
5. Sa tanksa ka, zakonisht, kompania?	Njëmëdhjetë tanksa.
6. Si është e formuar kompania?	Kompania e tanksavet mesatarë ka një sekcion shtabi me dy tanksa, një sekcion për mirëmbajtje dhe tri toga me nga tre tanksa secila.
7. Këtu është vendi ku është qëlluar tanksi juaj, Zoti Kapter; nga kjo pikë e gjer në rrugën Bratz, cilat rrugë keni vëzhguar?	Kam dalur nga fshati Gatz sot në mëngjes përmes rrugës Metz gjer sa arrita në kryqëzim të rrugëvet Metz dhe Bratz dhe u ktheva nga lindja në rrugën Bratz.
8. Sa tanksa ishin në këtë mision?	Tre tanksa.
9. Ç'u ngjau tanksavet tjerë kur u qëllua tanksi juaj?	Besoj të jenë kthyer ndër vijat tona.
10. A u krye misioni?	Po.
11. Si ishte rruga nga fshati Gatz gjer në kryqëzimin e rrugëvet Metz e Bratz?	Rruga ishte në gjëndje të mirë. Tanksat nuk patën vështirësi të kalojnë mbi rrugën e shtruar me rërë. Rruga ishte 15 m. e gjërë.

12. Në ç'gjëndje e keni gjetur të vetmen urë çementoje që gjëndet në këtë rrugë?

Ura ishte në gjëndje të mirë. Dy tanksa e kaluan urën krah për krah, pa asnjë vështirësi.

13. Çfarë armësh artilerie keni vënë re ose keni dëgjuar në mes këtyre dy vendeve?

Asnjë.

14. Sa njerëz keni parë?

S'kam parë njeri.

15. Ç'aktivitet tjatër ushtarak keni vënë re?

Mund të ju duket e çuditshme por ne ishim të vetmit n'atë vend.

16. Në ç'gjëndje ishte rruga ndërmjet kryqëzimit të rrugëvet dhe vendit ku u zutë rob?

Rruga është e shtruar me zift dhe me gjithë se kishte disa gropa, tanksat nuk patën vështirësi të kalojnë.

17. Në ç'gjëndje ishte ura e parë që kaluat pasi u larguat nga kryqëzimi i rrugëvet në drejtim të vendit ku u zutë rob?

Nuk kaluam nëpër urë, pasi ishte e shkatërruar.

18. Si e kaluat lumin?

Gjetëm një va të përshtatshëm që të kalonin tanksat. Ishte pothuaj 50 m. në veri t'urës. Kaluam nëpër këtë va dhe pastaj u kthyem në rrugë.

19. Sa i gjërë ishte vau?

Pothuaj 10 m.

20. Në ç'gjëndje ishte ura tjatër?

S'kemi kaluar ndonjë urë tjatër. Besoj të ketë qenë një urë druri n'atë vend, por më duket se është prishur.

21. Si e kaluat këtë lum?

Shikuam mos të gjenim ndonjë va, por s'gjetëm gjë, prandaj, kontrolluam urën e hekurudhës mbi të cilën kalojnë një palë binarë, pothuaj 400 m. në jug të rrugës. Pamë se tanksat,

një nga një mund të kalonin mbi këtë urë. Na u desh një orë e gjysmë që tre tanksa të kalonin lumin mbi këtë urë hekurudhore.

22. Ç'aktivitet ushtarak keni vënë re ndërmjet kryqëzimit të rrugëvet dhe vendit ku u zutë rob?

Duke qenë në zonën tuaj, s'pamë gjë gjer sa ushtarët tuaj qëlluan kundër nesh në vendin ku na zunë rob.

PUSHKATARI

PJESA I

1. Pasi e ke humbur letër-njoftimin, duhet të të bëjmë ca pyetje për të vendosur mbi identitetin tënd të vërtetë dhe për të siguruar të drejtat e tua si rob lufte. Si e ke emrin dhe ç'numër ushtarak ke?	Më quajnë William A.Jackson. Jam tetar dhe numri im ushtarak është 39 045 999.
2. Nga ç'njësi je?	Jam nga Regjimenti i 666-të i Këmbësorisë së Divizionit të 999-të.
3. Tani më thuaj se në ç'kompani dhe në ç'batalion je!	Jam në Kompaninë A të Batalionit të 1-rë.
4. Ç'detyrë ke në Kompaninë A?	Jam pushkatar i thjeshtë.
5. Në ç'skuadër dhe në ç'togë je?	Jam në Skuadrën e 3-të të Togës së 3-rë.
6. Sa skuadra pushkatarësh ka në togën tënde?	Tri.
7. Sa është forca m'e madhe e skuadrës sate dhe ç'lloj armësh ka?	Forca m'e madhe e skuadrës është 9 veta. Ka pushkë të kalibrit .30. Të tërë kanë pushkë, përveç dy vetave, të cilët kanë pushkë automatike.
8. Ç'forcë kishte skuadra kur u largove prej saj?	Kishte maksimumin e forcës.
9. A ka toga jote skuadër armësh? Në qoftë se ka, nga se përbëhet?	Po, kishim një skuadër armësh. Kishte dy mitraloza të lehtë.
10. Dy mitraloza të lehtë thatë?	Po. Ishin të vetmet armë n'atë skuadër që kishin personel.

11. A e kishte maksimumin e forcës skuadra e armëvet?

Pesoj se po.

12. Ç'u bë bazuka që kishit në skuadrën e armëvet?

E kanë shpënë në shtabin e togës.

13. Nga sa vetë përbëhet tani shtabi i togës?

Më falni! Duhet t'i numroj. Ka një kapter toge; pastaj është ndihmësi i kapterit të togës; ka dy përndas letrash e komunikimesh; ka një skuadër katër vetash për bazukë; ka një kryetar toge me gradë toger. O, gati harrova, ka dhe një infermier.

14. A e kishte shtabi i togës maksimumin e forcës kur u largove s'andejmi?

Jo, togeri u vra dje nga një predhë artilerie; një nga ata që zëvendësonte një tjatër, ay që mbar municionin, u dogj keqas nga zbythja e bazukës dhe e larguan nga fronti.

15. Sa toga pushkatarësh kishte kompania jote?

Kishte tri toga dhe një togë armësh.

16. Çfarë armësh kishte toga e armëvet?

Kishte një sekcion mortajash dhe një sekcion armësh që nuk zmbrapsen kur zbrazen.

17. Do të thuash një sekcion pushkësh që nuk zmbrapsen kur zbrazen.

Po, pushkë të gjata 57 mm.

18. Sa armë kishte secili nga këto sekcione?

Më parë kishte tri mortaja dhe tri pushkë që nuk zmbrapsen kur zbrazen, por tani nuk e di sa kanë.

19. Sa njerëz ka në shtabin e kompanisë?

Nuk e di me siguri, por kam dëgjuar, duke llafosur për togën e shtabit, se janë pothuaj 40 veta.

20. A ka komanda e kompanisë ndonjë armë që nuk e kanë togat tjera?

Kam dëgjuar se ka një armë të rëndë kalibër .50 dhe një bazukë, të cilat besoj se i përdorin kapteri dhe

gjellbërësit në rast nevoje të jashtëzakonshme.

21. Kush tjatër është në komandën e kompanisë, përveç kapterit dhe gjellbërësvet?

Ka një sekcion komunikacicnesh, shofera, ordinancin e kolonelit dhe atë që punon në zyrën e kompanisë.

22. Sa është forca e kompanisë sate tani?

Kam dëgjuar oficerin ekzekutiv duke thënë se kishim 200 bajoneta gati për ushtarët tuaj, në rast se do të na sulmonin. Kjo ka qenë dy javë të shkuara.

PUSHKATARI

PJESA II

23. Ti përmende një sekcion ndërlidhje. Çfarë lloj mjetesh për ndërlidhje keni në kompani?

Kishim radio, 536-shin dhe 300-shin dhe telefone.

24. Sa prej tyre kishit në togë?

Kishim një telefon fushor që s'ka lidhje me central dhe një tjatër 536-sh.

25. Sa të mëdha ishin radiot dhe telefonet që kishte komanda e kompanisë?

Kishim të paktën një, ndofta dy telefone EE8 dhe një ose dy radio SCR 300.

26. A kishte toga e armëvet ndonjë telefon EE8 dhe radio SCR 300?

Me sa di unë, jo.

27. Çfarë centrali përdorte sekcioni i kompanisë?

Ishte fare i vogël dhe kishte ca pulla, dritat e të cilave ndizen kur ndonjë thërret. Nuk e di si quhet ky telefon.

28. Në një kompani të madhe, siç është juaja, prej po-thuaj 200 vetash, duhet të ketë edhe automjete. Sa kishit ju dhe ç'madhësie ishin?

Kishim një kamion 6 X 6 për kuzhinë dhe 3-¼ automobila të tipit xhip. Besoj se secili prej këtyre të fundit kishte rimork.

29. Sa mund të mbarin?

Kamioni i kuzhinës ishte dy tonash e gjysmë dhe xhipat ishin një çerek toni.

30. Për se i përdornin xhipat?

Dy ishin në togën e armëvet dhe dy të tjerët shërbenin për të dërguar municion në togat e pushkatarëvet dhe për të transportuar të plagosur nga fronti, por asnjë nga togat e pushkatarëvet nuk kishte automjet të sajin.

31. A kishte komandanti i kompanisë xhip për vete?

Po, kishte më parë, por pastaj e dërguan n'autopark për t'a ndrequr.

32. Si quhej komandanti yt?

Kapiten Smith.

33. A e donin ushtarët e kompanisë komandantin e tyre?

Besoj se është burr mjaft i mençëm dhe gjithënjë është sjellur mirë me cilindo që kishte punë me të. Është pak përtac; i linte oficerit ekzekutiv shumë punë që i përkisnin vëzhgimit, si dhe gjëra tjera që kërkonin mundim, si për t'ecur nëpër kodra etj.

34. Si quhej oficeri ekzekutiv?

Toger Miller; shumë burr i mirë.

35. A kishin kryetarë të tëra togat e kompanisë?

Të tëra, përveç simes.

36. Si e quanin?

Toger Martinez-i kishte nën komandë Togën e 1-rë dhe Toger O'Neil-i kishte të katërtën. Nuk e di se nën komandën e kujt ishte e dyta; më duket se ishte nën komandën e një oficeri të ri, që kishte ardhur drejt nga qendra e ushtrisë që merret me zëvëndësimet.

37. Si e quanin komandantin e batalionit, komandantin e regjimentit dhe komandantin e divizionit?

Kolonel George ishte komandanti i regjimentit dhe Gjeneral Wilson komandanti i divizionit. Nuk më kujtohet emri i komandantit të batalionit; ishte një kolonel, fytyrë e re.

38. Si ishte morali në kompaninë tënde?

I lartë, të shumtën e kohës.

39. Pse s'ishte i lartë gjithënjë?

Që të gjithë qemë mjaft të demoralizuar muajin e kaluar, pasi s'patëm mjaft për të ngrënë për dy muaj a më tepër. Gjithashtu ishim të zemëruar sepse kur fi-

lloi dëbora e të ftohtit ende s'kishim çizme dimri, por më së fundi erdhën për të tërë.

40. Pak kohë më parë, ti përmende humbje. A kanë qenë të rënda në këto kohët e fundit?

Jo shumë të rënda gjer dje, kur artileria juaj goditi gjashtë veta. Kani shtënë shumë predha të 105-shit, të cilat zunë përjashta, të pambrojtur, disa nga tanët.

41. Në ç'kohë të ditës ngjau kjo?

Andej nga ora 4.30 pasdreke, tamam kur po vinte gjella.

42. A ju kanë dhënë gjellë të ngrohta n'atë pozicion?

Po, të shumtën e herës kemi pasur tri gjellë të ngrohta në ditë, përveç togës që është pararojë. Ata hanin gjellë kutishë çdo herë.

43. Ti ishe vetëm kur të zunë rob. Ku ishin pjesëtarët tjerë të skuadrës sate?

Ishin prapa, në pozicionin e skuadrës në vijën kryesore të rezistencës.

44. A ishte e tërë toga në front n'atë kohë?

Po, ishte në të mëngjër të skuadrës sime.

45. Ç'lloj armësh, me personel përkatës, kishte në zonën e togës sate?

Më kujtohet se kam parë një mitraloz të lehtë në zonën e skuadrës së dytë dhe një bazukë kalibër 3.5 në skuadrën e parë afër rrugës.

46. A ishte pjesa tjatër e kompanisë në vijën e frontit?

Toga e 1-rë ishte n'anën tonë të mëngjër dhe e dyta ishte si pararojë pothuaj 300 m. përpara vijës kryesore të rezistencës. Besoj se toga e armëvet ishte e ndarë në mes të tjerave.

47. Ç'gjatësi të frontit zinte kompania jote?

Afërsisht 350 m. gjatësi.

48. Ç'njësi kishit më të djathtë dhe më të mëngjër?

Batalioni i 3-të ishte më të djathtë të togës sime dhe Kompania C më të mëngjër.

49. A e di se kush ishte më të mëngjër të batalionit tënd?

Besoj se një sektor i divizionit gjendej më të mëngjër të Kompanisë C. Kam dëgjuar se parashutistët e 888-shit e morën përsipër mbrojtjen e atij sektori.

50. Ti the "e morën përsipër". A mos do të thuash se ndonjëra nga njësitë më të

Jo, ajo pjesë ishte bosh gjer ca dit më parë. Më kujtohet një ushtar i Kom-

mëngjër është zëvëndësuar në këto kohët e fundit?	panisë C duke thënë se ndiheshin pak të dobët në të tërë krahun e mëngjër të zbuluar.
51. Me dy kompani në front, batalioni duhet të ketë pasur ndonjë rezervë. E di se ku gjëndeshin?	Kompania B nuk ishte në front; nuk e di se ku ishte. Kompania D kishte një sekcion t'armëvet të rëndа në krahun e djathtë tonin; këto janë të tëra armët e tyre që kam parë.
52. Pasi njësia jote ishte e vendosur në një pozitë mbrojtje, duhet t'a kishit në plan të qëndronit aty për ca kohë. Mos ke dëgjuar gjëkafshë se do të lëviznit ose do të fillonit ndonjë ofensivë?	Jo, s'kam dëgjuar gjëkafshë. Na thanë se një njësi tjatër do t'a merrte përsipër tërë barrën e mbrojtjes për ca kohë. Divizioni ynë nuk do të luante nga vendi dhe t'ju a linte juve të thyenit kokën kundër pozicionevet tona po të sulmonit.
53. Duket sikur kishit pozicione të forta. A kishit pengesa telash me gjëmba dhe mina përpara llogorevet tuaja?	Po, sigurisht; kishim tela me gjëmba dhe mina.
54. Çfarë lloji ishte teli: nga ay që mbështillet e bëhet gyp, nga ay që është i ngatërruar, apo nga të dy?	Përpara vijës kryesore të qëndresës kishte tela që ngatërrohen, tri gardhe të forta. Këtë e di sepse isha mbrëmë për t'i ndrequr kur patrulla juaj më zuri rob.
55. A e di sa e gjërë ishte fusha e minuar përpara jush?	Pothuaj 50 jardë.
56. Ç'rrugë të sigurt kishte për të kaluar në vendin e rrethuar me tela me gjëmba dhe nëpër fushën e minuar?	Rrinim gjithënjë në rrugën që kalon përmes togës sime dhe asaj pjese që kthehet nga e djathta e pararojës. S'kam dëgjuar kurrë për ndonjë rrugë më të sigurt për të vajtur përpara vijës kryesore të qëndresës.

57. A kishte pengesa rruga që kalon përmes pozicionevet tuaja?

Po, kishte një gardh të madh dhe të gjatë dhe një hendek përmes saj, tamam nga e djathta e pararojës.

58. A kishte mina përpara telavet?

Më duket se kishte ca, por nuk jam i sigurt.

59. A kishte ndonjë prej armëvet tuaja të rënda zonë zjarri që t'a përfshinte mbrojtjen e pengesavet të rrugës?

Po, të tëra armët ishin drejtuar nga pengesat në rrugë; dy 30-shat e rëndë, bazuka jonë, mitralozi i lehtë dhe një vëzhgues që rri përpara, prej sekcionit të 60-shavet shikonin drejt nga pengesat e rrugës. Asnjë tanks nuk mund të kalonte n'atë vend të rrugës.

60. Ku ishte kjo pararojë që the?

Ishte në kodër prapa, në drejtim të pararojës së kompanisë.

61. Ku ishte pararoja e kompanisë?

Ishte mu në majë të kodrës prapa togës sime dhe ishte fshehur aq mirë sa duhet t'ishit pak çapa larg tyre për t'i zbuluar.

62. A kishte vëzhgues tjerë që rrinë përpara në zonën e kompanisë, përveç vëzhguesit të mortajavet 60 mm.?

Për sa di unë, jo.

63. Ku ishte pozicioni i mortajavet?

Mortajat ishin vendosur në bateri, poshtë kodrës, afër komandës së kompanisë. Edhe kuzhina jonë ishte aty prapa.

PUSHKATARI

PJESA IV

64. A është pozicioni përpara vijës së qëndresës pjesë e vijës së qëndresës së pararojës?

Po, është pjesë e vijës së qëndresës së pararojës.

65. Çfarë armësh ka në këtë pozicion, përveç armëvet të zakonshme që ka një togë pushkatarësh?

Më parë kishte një pushkë 75 mm., por nuk e di në se është gjithënjë aty. Toga ime është larguar nga pararoja një javë më parë.

66. Mos je duke llafosur për pushkën 75 mm. që nuk zmbrapet kur zbrazet?

Po, është e Kompanisë D.

67. A kishte ndonjë pararojë atje? Në qoftë se po, thuamë, ç'pararojë!

Po, kishte një vëzhgues që rri përpara me një 81 mm. të vendosur në majë të kodrës nga e djathta.

68. A ishte edhe vëzhguesi i Kompanisë D?

Po, por ay mund të kërkonte edhe ndihmë nga mortajat 4.2" dhe artileria.

69. Ç'lloj teli kishit atje?

Kishim gypa teli të vendosur në formë piramide rreth e përqark kodrës. Dy nga këta gypa prej teli me gjëmba ishin të vendosur poshtë (shtrirë) dhe një përsipër tyre. Pastaj ishte edhe teli i posaçëm, që, në rast se ndokush takonte telat natën, raketat hapnin zjarr.

70. A kishte mina përreth pozicionit të vijës së qëndresës së pararojës?

Jo tamam përreth, por minat u shtrinin nga lindja, që nga rrëza e kodrës e gjer ke pengesat në rrugë dhe nga perëndimi gjer ke kodrina tjatër.

71. A ishte i minuar vendi në mes dy majave të malit që gjëndet në qendër të pararojës?

Jo, por kishte një përqëndrim mortajash 60 mm. gati për qitje. Ditën që arritëm atje kanë shtirë kundër atij përqëndrimi dhe të tërë u futëm ndër fortifikata, që të mos u qëllonim nga copat e predhavet.

72. Fortifikatat që the, a mos ishin vallë për banim, apo ishin si pozicione luftimi?

Fortifikatat janë të ndërtuara në mënyrë që mund të lëftonim pa dalur jashtë tyre, por pozicionet kryesore të luftimit janë në një llogore që kalon nga maja ushtarake e kodrës dhe shtrihet rreth e përqark saj. Kishim një perimetër vërtet të fortë, të siguruar nga të tëra anët.

73. A nxirte pararoje patrulla, grupe pusishë etj.?

Jo, të tëra patrullat vinin nga vija kryesore e qëndresës ose nga njësitë rezervë.

74. A e di rrugën që merrnin këto patrulla?

E vetmja udhë që di unë është ajo që shkon poshtë rrugës dhe që kthehet nga perëndimi ndërmjet fushës së minuar dhe pararojës. Se nga venin patrullat nga aty nuk e di.

75. Sa patrulla nxirte toga juaj, të themi, në një javë?

Katër, pesë.

76. Ç'patrulla ishin?

S'kam vajtur asnjëherë në patrullë, sepse më zinte kolla shumë dhe togeri mendonte se do t'ishte e rrezikshme për sigurinë tonë. E vetmja gjë që kam dëgjuar është se çdo togë nxirte me radhë patrulla luftimi dhe vëzhgimi. Tani që kemi rrobe dimri besoj të fillojmë të nxjerrim edhe patrulla pusie.

I-8

77. Ti the se pararoja mund të kërkonte ndihmë nga artileria. Çfarë copash artilerie e mbrojnë pararojën tuaj?

Kompania e 1-rë Fushore ka qenë gjithënjë me neve, kështu që besoj se 105-shi i tyre do t'a kryente këtë punë.

78. A dini ndonjë njësi tjatër artilerie që shtie për njësinë tuaj?

Kam dëgjuar 8-shat që ishin pas nesh, por nuk i kam parë ndonjë herë duke shtënë.

79. A kishi ndonjë tanks në zonën tuaj?

Regjimenti ka një kompani tanksash, por vetëm një herë i kam parë duke shtënë kur erdhëm në front dhe qitën pothuaj 24-25 herë. Ü tërhoqën menjëherë kur artileria juaj hapi zjarr kundër tyre.

80. Ç'model ishin këta tanksa?

Kapteri i togës thonte se ishin "tetsha të kollajtë" me topa 76 mm. "Tetësh i kollajtë" duhet të jetë numri i modelit.

PUSHKATARI

PJESA V

81. Si e ke emrin dhe ç'gradë ke?	Petrov Andrei Michaelovich, ushtar.
82. Në ç'njësi je?	Jam në Sekcionin e Shtabit të Kompanisë së 1-rë Pushkatare të Batalionit të 2-të të Regjimentit të 4-të Pushkatar të Divizionit të 1-rë Pushkatar të Rojevet.
83. Ç'detyrë ke në kompani?	Jam shofer.
84. Çfarë maqine nget?	Një kamion 4 x 4 Gaz-67, por di të ngas edhe kamiona 4 x 2 Gaz-51.
85. Çfarë lloj motori ka kamioni 4 x 4 Gaz-67?	Ka motor të zakonshëm katër cilindrash që punon me benzinë.
86. Qysh ftohet motori?	Ka radiator me ujë.
87. Ç'shpejtësi ka?	Nuk e di. Nuk duhet t'a ngitnim më shumë se 40 km. n'orë ndër rrugë të shtruara.
88. Ç'karroceri ka ky automjet?	Shpinja kapitenin poshtë e lart me atë maqinë. Është si xhipat tuaj. Ka paranga më të larta se xhipi juaj dhe dalin jashtë shumë nga karroceria.
89. Ti the se me këtë kamion çonje dhe merrnje kapitenin. Ku e çonje kapitenin?	Në Komandë të Batalionit dhe në Kompaninë e 2-të; n'asnjë vend tjatër.
90. Ku gjëndet Komanda e Batalionit?	Është 15 km. në veri të vendit ku më zutë dhe dje isha atje.

91. Ku gjëndet komanda jote nga vendi ku të zunë rob?

Nga kryqëzimi i rrugëvet ku më zunë, për të vajtur në kompaninë time duhet të veni 4 km. në perëndim të një ure prej druri, t'a kaloni këtë urë, të ktheheni djathtas dhe të hyni në pyll, në një vend ku janë prerë pemët për të ndaluar përhapjen e zjarrit, në rast zjarri. Duhet t'ecni 30 m. gjatë këtij vendi gjer në një tatëpjetë dhe komanda është nga e djathta juaj në gjysmë të rrugës së kësaj tatëpjetë të kodrës.

92. Ç'rrugë është ajo që të shpie në komandën e batalionit tënd?

Nga komanda e kompanisë gjer në kryqëzimin e rrugëvet, rruga është e shtruar me zhur e me dhe, kurse në veri të kryqëzimit të rrugëvet rruga është e shtruar me asfalt.

93. Ku gjënden togat tuaja?

Nuk e di, pasi komandanti i kompanisë s'ka vajtur asnjëherë atje dhe as që kam dëgjuar njeri të thoshte se ku gjënden.

94. Me çfarë arme ishte i armatosur kapiteni?

Kishte një revole; besoj t'ishte TT M1933 Tokarev. E kam parë s'afërmi një herë. Për pushkën time që më morën mund të flas më gjatë se për revolen e kapitenit. Kisha një pushkë automatike kalibër 7.62 PPS-1943. Ishte armë e mirë; dorëza i hiqet dhe i vihet; mbështillet (thyhet) dhe është e lehtë të mbaret. Edhe po t'a humbja mund të merrnja një nga shokët në sekcionin e shtabit, pasi të tërë ushtarët kishin nga një.

95. Tregomë se ç'dë për këtë armë: sa herë në minutë shtie, ç'peshë e ç'gjatësi ka, sa fishekë zë, ç'shenjestër ka dhe çë shpejtësi ka plumbi!

Nuk mbaj në mend shumë mbi shenjestrat e saja, por di se plumbi ka një shpejtësi prej 1640 këmbësh në sekondë, vret pothuaj 203 m. larg, "gjatësia e tërë", siç e quani ju, është 32 inç me dorëz të shtrirë dhe 24 inç me dorëz të mështiellur. Ka karikator 35 fishekësh dhe shtie 600 herë në minutë, megjithëqë tani shtiem 100 herë në minutë. Zmbrapet kur shtie dhe ftohet me ajr. Nuk kam dijeni për armët tjera të njësisë; për këto arësye më kanë caktuar shofer të kapitenit.

122

OFICERI I POSAÇËM I SHTABIT

1. Tungjatjeta, Zotëri! Si e keni emrin?

   Contalvo Juan Valencia Ugspucci, kapiten.

2. Në ç'njësi jeni?

   Në Kompaninë e Komandës së Regjimentit të 151-të të Këmbësorisë.

3. Në cilin divizion bën pjesë?

   Në Divizionin e 62-të Pushkatar.

4. Ç'detyrë keni n'at regjiment?

   Jam oficer i Ndërlidhjevet të Regjimentit.

5. Sa kohë ka që e keni këtë detyrë?

   Nja 6 javë.

6. Ku ishit para se t'u bëjshit oficer ndërlidhës?

   Kam zëvëndësuar një tjatër. Kam ardhur nga Instituti i Sinjalevet në Southofen.

7. Cilat janë detyrat tuaja si oficer ndërlidhës?

   Jam përgjegjës për të mbajtur në veprim tërë kohën shërbimin radiofonik në regjiment.

8. Mirë. Ç'janë ato karta që patët me vete kur ju zunë rob?

   Një ishte një hartë në formë skice që tregonte vijat telefonike dhe telegrafike, kurse tjatra ishte një diagram.

9. Ç'është një diagram?

   Një diagram skematik tregon të tëra stacionet radiotelegrafike. Tregon gjithashtu, se si të vihesh në kontakt me çdo stacion brenda rrjetës së radiofuzionit.

10. Si qe puna që ju zunë rob?

    Po venja t'i dorëzonja personalisht këta dokumenta njërit prej oficerave të ndërlidhjes së batalionit. Pastaj humbëm rrugën dhe na zuri patrulla juaj.

11. M'intereson toga juaj e sinjalevet. Kam dëgjuar se është togë më vete, apo jo?

Ashtu është, zakonisht. Komandanti i Divizionit, Gjeneral Divizioni Germino, vendosi që togat e sinjalevet, toga e xhenios dhe ajo e shëndetësisë për këtë operacion të mvareshin drejt për drejt nga kompania e kuartierit të regjimentit.

12. Pse?

Kam dëgjuar se kjo u bë për arësye administrative.

13. A do të mvaret për gjithënjë personeli i togës suaj nga kompania e kuartierit?

Jo, vetëm për këtë operacion.

14. Sa është forca, sipas Kuadrit të Personelit dhe të Pajisjes?

Pesë oficerë dhe 40 ushtarë.

15. Sa prej tyre janë tani në krye të detyrës?

Të tërë.

16. Ç'detyrë kanë oficerët?

Unë jam komandanti dhe natyrisht jam edhe në shtabin e regjimentit.

17. Ay është Shtabi i Posaçëm, apo jo?

Natyrisht. Kam një toger, i cili është oficeri im ekzekutiv dhe merret me kuartierin e togës. Një tjatër ka skuadrën e radios, kurse njëri nga dy të tjerët ka sekcionin që është i ngarkuar të mbajë në rregull telat e telefonit dhe tjatri sekcionin e mirëmbajtjes.

18. Ç'lloj telefonesh keni në bazë të Kuadrit të Personelit dhe të Pajisjes?

Kemi një lloj telefoni, të cilin më duket se ju e quani EE8.

19. Ç'tel përdorni?

Përdorim disa lloje, por atë që përdorim më shumë e quajnë 110.

20. Ç'radio përdor regjimenti juaj?	Përdor radio FM 510.
21. Cila është shenja thirrëse e regjimentit tuaj?	Kaballero.
22. Kush është komandanti i regjimentit tuaj?	Kolonel Ramaros Valenti Costanto Ramond.
23. Kush është oficeri ekzekutiv i tij?	Nënkolonel Fernando Roberto Cabra.
24. Cila është detyra e tij?	Zëvendëson komandantin kur mungon. Përndryshe merret me punët e komandës, në mënyrë që kjo të funksionojë mirë.
25. Ku gjëndet komanda?	Në Belisque.
26. Ç'detyrë ka oficeri administrativ?	O, mos doni të thoni për "kryetarin e shërbimevet"? Këtë detyrë e ka Nënkolonel Manuel Vellar. Ky merret me të tëra punët administrative që i përkasin personelit. Bën raportet e mëngjesit të regjimentit, raportet e forcës (sa është forca), raportet e humbjevet në njerëz, lutjet e oficerëvet që kërkojnë leje, kërkesat për zëvendësime dhe gjëra tjera.
27. Kush është oficeri i stërvitjevet dhe i operacionevet dhe ç'detyrë ka?	Është Kapiten Philipi Rodrigues Costanti. Ay është përgjegjës kundrejt Kolonelit për të tëra stërvitjet brenda në regjiment. Gjithashtu merret me planet e hollësishme për operacionet ushtarake.
28. Unë kam menduar se Komandanti është oficeri përgjegjës për çdo gjë në regjiment, apo nuk është ashtu?	Ashtu është; ay është përgjegjës. Oficeri i Operacionevet dhe i Stërvitjevet merret me ushtarët që bëjnë punë të posaçme të përkohëshme, si roje etj.

29. Ç'detyrë ka oficeri i shërbimit të fshehtë dhe si e quajnë?

Oficeri i shërbimit të fshehtë është Major Fulucci Torris. Detyra e tij kryesore është të mbledhi informata mbi armikun, mbi qëllimet e tija, mbi motin dhe zonën e pushtuar nga armiku që gjëndet përballë frontit tonë dhe të tëra këto informata t'i a paraqesi me shkrim Kolonelit, në formë të posaçme për shërbim të fshehtë.

30. Kush merret me furnizime në regjiment?

Kapiten Toni Gonzollas. Ky nuk është vetëm oficeri i furnizimevet, por është gjithashtu komandanti i shtabit të regjimentit. Detyra e tij, përveç furnizimevet, përfshin edhe administratën e kompanisë së shtabit të regjimentit. Është edhe përgjegjës për mirëmbajtjen e automjetevet në kompani.

31. Kush është kirurgu i regjimentit dhe ç'detyrë ka?

Është Kapiten Georgi Sabastian Martini. Ka nën komandë Togën e Shëndetësisë dhe natyrisht, si i tillë, ka nën kujdes shërimin e të sëmurëvet dhe të të plagosurvet. Gjithashtu merret edhe me largimin nga fronti t'atyre që janë shumë të sëmurë ose të plagosur rëndë, duke i dërguar në spitalin fushor me anë t'autoambulancavet të kompanivet.

32. Ç'detyrë ka toga e xhenios dhe nën komandën e kujt është?

Është nën komandën e Kapiten Pedro Cartagena-s. Kam dëgjuar se n'ushtrinë tuaj xhenioja merret shumë me ndërtimin e rrugëvet, me vënien e minavet dhe të telavet me gjëmba etj. N'ushtrinë Sulmonjëse ata të xhenios janë vetëm specia-

listë. U mësojn" ushtarëvet të frontit se si të minojnë dhe si të ndërtojnë ura për këmbësorë dhe për automjete të vogla. Heqin mina nga fushat e minuara, ndërtojnë fortifikata të posaçme si dhe pengesa për rrugë. Kanë një sekcion që merret me shkatërrime, i cili për punë të posaçme shkatërrimi përdor eksploziv të fuqishëm në formë torbe ose në forma tjera.

33. Ç'gjëje i referoheni kur flitni për "punë të posaçme shkatërrimi"?

Flas për fortifikata të posaçme për armë, për fortifikata tjera që ndërtohen përpara armëvet për t'i mbrojtur si dhe për pengesa nga të tëra llojet, të cilat mund t'i pengojnë trupat tona.

34. Shumë bukur, Zoti Kapiten Valencia! Ju falem nderit për këtë bisedim të lezeçëm që patëm.

FORMA E TERENIT

PJESA I

1. Ç'numër ushtarak ke?	0733216.
2. A është ky letërnjoftimi yt?	Po.
3. Ku të zunë rob?	Aty ku bashkohen dy lumenjt.
4. Nga vinje?	Nga tjatra anë e lumit.
5. Cilin lum kalove?	Lumin më të madh; nuk i a di emrin.
6. Ku e kalove lumin?	Në va, në vendin ku ka tokë.
7. Ç'do të thuash me fjalët "në vendin ku ka tokë"?	Është një vend ku bregu hyn pak në lum. N'atë pikë është një vend me rërë që shkon pothuaj matanë lumit. Ky vend formon një va të mirë.
8. Sa i thellë është lumi n'atë vend?	Përveç kanalit, s'është më tepër se një metër thellë.
9. Sa i thellë është kanali?	Kur e kaluam mbrëmë ishte pak më tepër se një metër e gjysmë thellë.
10. Sa i gjerë është kanali në vendin ku e kalove lumin?	Do të thonja se është nja 4 a 5 metra i gjerë.
11. Në ç'vend të lumit gjendet kanali?	Të mendoj pak. Do të thonja se është nja 2 metra nga ana jonë e lumit.
12. Ç'mision kishe?	Nuk e di se ç'doni të thoni me fjalën "Mision"?
13. Ç'ishi duke bërë në këtë anë të lumit?	Të ju thom të vërtetën, nuk jam i sigurt. Kapteri na tha se ishim duke vajtur të shifnim se ç'ishin duke bërë Amerikanët në vendin që

formohet nga bashkimi i dy lumenjve.

14. Ç'donte të thonte kapteri me fjalët "në vendin ku ka tokë"?

Nuk e di. U ndava nga patrulla sepse humba rrugën posa i u ngjitëm barkas bregut të lumit dhe, kur po u mundonja t'i gjenja shokët e patrullës, më zunë rob.

15. Sa veta kishte patrulla?

Gjithësejt ishim tetë veta.

16. Nga cila njësi ishin?

Të tërë ishim të Togës së 2-të të Kompanisë së 1-rë.

FORMA E TERENIT

PJESA II

17. Kush e ngarkoi kapterin me atë mision?

Oficeri i Shërbimit të Fshehtë të Batalionit e ngarkoi me atë mision.

18. Në ç'kohë ke qenë në komandën e batalionit?

Aty nga ora 4 pasdreke.

19. Ku gjëndet komanda e batalionit?

Prapa një kodre.

20. M'a përshkruaj formën e terenit përreth komandës!

Të mejtoj pak. Në majë të kodrës janë disa gurë të dalur jashtë dhe nga ky vend mund të shifet lumi.

21. Ç'formë tjatër ka tereni?

Është pylli që përmenda. Komanda gjëndet afër pjesës perëndimore të një vendi në pyll që është pa pemë.

22. Ç'tjatër paraqet tereni andej rrotull dhe që është bërë nga dora e njeriut?

Rruga që vete nga Anges është shumë afër këtij vendi.

23. Ç'tjatër ka aty afër?

Ka një urë të vogël në rrugë, e cila kalon përmbi shtratin pa ujë të lumit. Duhet të ktheheni nga e djathta e rrugës dhe të veni gjatë shtratit të lumit nga e djathta. Komanda gjëndet nja 75 m. nga rruga.

24. Ti the se duhet të kthehesh nga e djathta e rrugës. Në ç'drejtim vete kur kthehesh nga e djathta?

Largohesh nga kompania në drejtim t'Anges.

25. Kjo është rruga Anges që je duke përshkruar?

Po.

26. Ç'pyje tjera ka andej pari?

S'kam parë asnjë. Ka pak pyll afër kompanisë sonë dhe nuk di tjatër pyll n'atë zonë.

27. Ku gjëndet kompania jote nga komanda e batalionit?

Afro një gjysmë kilometri pothuaj në drejtim të frontit.

28. Ç'do të thotë fjala "pothuaj"?

Tamam, është pothuaj në drejtim të frontit. Rruga që kalon afër komandës së batalionit është pothuaj aq larg nga batalioni sa edhe nga kompania.

29. Ç'formë tereni me rendësi ka n'afërsitë e kompanisë?

Siç thash më parë, gjëndet në një pyll në përpjetën e përparme të një kodre. Pararojat tona gjënden në breg të lumit, prandaj, siç e shifni, nuk është larg nga lumi.

30. M'a përshkruaj kodrën që përmende!

Ndofta s'është tamam kodër. Besoj të jetë bishti i një vargu kodrash, që gjëndet pothuaj në gjysmë të rrugës, ndërmjet kompanisë dhe Anges. Pas kodrës është një luginë ose greminë, në të cilën gjëndet komanda. Kodra mbaron në një shkrep kur zbret në fund të greminës. Kam vënë re se ka shumë shpella në këtë greminë. Ndër këto shpella mbajmë municion dhe furnizime. Ka edhe ca mortaja të regjimentit në këtë greminë, ndërmjet kompanisë dhe rrugës. Sadoqë gremina vete paralel me lumin, në këtë vend ka një rrugë të ngushtë që të shpie nga gremina pothuaj në lum. Kam dëgjuar se kjo rrugë e ngushtë është shtrati i vjetër i lumit. Toga ime gjëndet mu në mbarim të kësaj rruge të ngushtë, tek pika më e afërt kur i afrohe lumit.

131

FORMA E TERENIT

PJESA III

31. Sa i gjërë është fronti i kompanisë sate?

Toga ime shtrihet nga rruga në të djathtë të bregores aty ku bën kthesë lumi. Lumi ka shpuar një shkrep dhe ka bërë një tatëpjetë thikë n'atë vend. Kjo tatëpjetë është në të mëngjër të togës sime. Toga e 1-rë është n'anën e mëngjër tonën dhe shtrihet tek një vend që ka qenë i punuar; më duket se ka qenë arë gruri. Tani ka shumë bimë të vogla në vendin gropa -gropa të fushës. Toga e 1-rë gjëndet mu në vendin gropa-gropa në buzë të lumit. Toga e 1-rë është e vendosur në mënyrë t'atillë, që armët e saja automatike mund t'i kontrollojnë të tëra kalimet për t'u avitur nga ana juaj e lumit. Është edhe një rrugë këmbësore që vete paralel me lumin. Ata janë ndër llogore ndërmjet kësaj dhe lumit.

32. Ç'kompani gjëndet më të djathtë kur je me fytyrë nga fronti?

Ajo është Kompania e 2-të e Batalionit tonë.

33. Si janë të rreshtuara trupat, duke pasur parasysh rrugën dhe lumin?

Të mendoj pak. Kam qenë dje atje për t'u parë me tim vëlla, kështu që besoj se e mbaj në mend se ku gjëndet kompania. Mu pas rrugës gjëndet një togë dhe toka n'atë vend është e sheshtë, pothuaj si një livadh. Toga

është e fshehur mirë ndër llogcre nga rruga gjer në kënetë, duke përdorur sa ka qenë e mundur bregore. Një mitraloz që është nja 20 m. nga rruga, duket si gur i dalur mbi tokë gjer sa t'i aviteni pak met.a pozicionit.

34. Ti the se kjo tokë është në këtë livadh; po togat tjera ku janë?

Toga e Dytë është n'anën tjatër të livadhit, në kënetë. Im vëlla është n'atë togë dhe më ka thënë se ushtarëvet nuk u pëlqen ay pozicion. Atje ka një përrua të vogël që rrjedh përmes kënetës dhe derdhet në lum. Toga e vëllait tim gjëndet andej pari, por nuk e di se ku gjëndet toga tjatër.

35. Ç'njësi gjëndet matanë përroit e kënetës?

Nuk e di. Kam dëgjuar tim vëlla duke thënë se trupat tona kanë vështirësi t'a marrin vesht gjuhën e tyre.

36. Si janë të futur ndër llogore ushtarët e togës ku është yt vëlla?

Ka kënetë pothuaj kudo, prandaj janë të detyruar të përdorin për pozicione kodrinat që ndodhen në kënetë.

37. Ç'njësi gjëndej n'anën e mëngjër tuajën?

Nuk e di me siguri. Kam dëgjuar një nga ushtarët duke thënë se kur kishte vajtur të marri gurë të thyer, aty ku thyhen gurë në zonën e tij, kishte marrë vesh se ata që punonin aty ishin të regjimentit tonë, por nuk tha se të cilit batalion ishin. Nuk di gjë për atë njësi.

FORMA E TERENIT

PJESA IV

38. Ku gjëndet Komanda e Regjimentit? — Gjëndet prapa, afër Anges.

39. Që kur? — Ka dy dit.

40. Ku gjëndet, duke pasur si bazë Anges? — Të mendoj pak. Mund t'a shifnja Anges nga hyrja në komandë, nga lindja. Qyteti gjëndet në majë të rrafshnaltës dhe mund të shifet nga një largësi mjaft të madhe. Divizioni gjëndet atje.

41. Si merret vesh, ti paske qenë në Komandën e Regjimentit! M'a përshkruaj rrugën që ke ndjekur për të vajtur n'atë vend! — Mirë. U nisa nga zona e kompanisë aty nga ora 5 në mëngjes dhe eca për të dalë në rrugë.

42. Në ç'rrugë? — Në rrugën që të shpie n'Anges, e cila kalon nga e djathta e pozicionit tonë.

43. E mora vesh. Vazhdo! — Kur arrita në rrugë u ktheva nga e djathta. Eca afro një gjysmë kilometri gjer në një vend ku rruga ka shumë kthesa në majë të kodrës. N'atë vend u ndalova nga një rojë që ruante një postblok.

44. M'a përshkruaj postblokun! — Atje është një kanal i vjetër, i cili, sikundër më kanë thënë, është i mirë si hendek kundër tanksavet. Rruga kalon nëpër një urë. N'anën tjatër të rrugës është një grumbull i vogël pemësh. N'atë vend ka një

top 76 mm. AT dhe besoj se ndër këto pemë ka një skuadër ushtarësh. Ka disa tokë të punuara, në të cilat xhenioja ka vënë shumë tela me gjëmba. Këto i janë përshtatur formës së terenit. Telat gjënden në të dyja anët e kanalit. Nuk më bie në mend të kem parë ose të kem dëgjuar se gjënden mina n'atë zonë.

45. A ka popullsi civile n'atë zonë?

Po, më parë kishte popullsi civile, por gjatë javës së fundit e kemi larguar s'andejmi, kështu që tani është zonë e pabanuar. Me gjithë këtë, ka banesa të shpërndara andej këtej.

46. Vazhdo!

Pasi i a tregova rojës letërnjoftimin vazhdova rrugën që vete gjer në majë të kodrës dhe kur u ngjita në majë kisha vapë dhe et, sepse përpjeta ishte e gjatë. Pranë kishës së vorrezavet që gjënden në majë të kodrës, ka një pus; aty piva ujë, hëngra një mollë, të cilën e këputa nga një mollë që gjëndej aty afër dhe u ula të pushoj duke duke shikuar panoramën. Larg në horizont shifen disa male të larta; një nga ato është shumë i lartë, maja e të cilit është plot me lëndë të mëdhaja. Ndërmjet këtij mali dhe vendit ku isha duke ndenjur është një liqen shumë i bukur. Vërtet nuk është shumë i madh, por është shumë i bukur. Nga ky vend mund të shihnja një lum të vogël, që rridhte rrëmbyeshëm në drejtim të liqenit.

47. Ç'bëre pasi pushove?

Vazhdova rrugën tatëpjetë në drejtim të Komandës së Regjimentit. Maja e kodrës është pjesë e një vargu malesh. Rruga dhe toka janë të mira në të zbritur. Tatëpjeta nuk është thikë sepse ka trupa pemësh të mëdhaja të djegura. Aty-këtu ka edhe livadhe të gjëra ose, si i quajnë disa, djerre. Rruga bën një kryqëzim me një rrugë tjatër që kalon perpendikularisht me rrugën në të cilën po venja. Atje është një hurdhë e vjetër me ujë, e cila formohet nga uji i një kroi që gjëndet n'atë vend. Çadra e komandantëvet gjëndet mu afër këtij vendi. Kaq di për Komandën e Regjimentit.

PËRMBAJTJE

ANTITANKS:

Pjesa I . . . . . faqe 1
Pjesa II . . . . . " 4

MJETE TË KORACUARA:

Pjesa I . . . . . " 7
Pjesa II . . . . . " 11

KËMBËSORI DHE MJETE TË KORACUARA . . . . . " 15

XHENIO:

Pjesa I . . . . . " 19
Pjesa II . . . . . " 22

PERSONEL I ARTILERISË:

Pjesa I . . . . . " 25
Pjesa II . . . . . " 28

ARTILERI FUSHORE:
Vëzhguesi që rri përpara . . . . . " 32
Oficer ndërlidhës . . . . . " 38

OFICER NDËRLIDHËS (REGJIMENT):

Pjesa I . . . . . " 42
Pjesa II . . . . . " 46
Pjesa III . . . . . " 49
Pjesa IV . . . . . " 52
Pjesa V . . . . . " 57

MITRALJERI . . . . . " 61

PERSONEL SHËNDETËSOR:

Pjesa I . . . . . " 64
Pjesa II . . . . . " 68

LAJMËTARI . . . . . " 71

SKUADRA E MORTAJAVET . . . . . " 74

ORGANIZIM DHE PAJISJE:

Pjesa I . . . . . faqe 76
Pjesa II . . . . . " 79
Pjesa III . . . . . " 82
Pjesa IV . . . . . " 86
Pjesa V . . . . . " 89

PATRULLË:

Kryetar Patrulle . . . . . " 92
Anëtar Patrulle . . . . . " 95

RADIST (RADIOTELEGRAFIST) . . . . . " 98

VËZHGIM . . . . . " 101

PUSHKATARI:

Pjesa I . . . . . " 104
Pjesa II . . . . . " 107
Pjesa III . . . . . " 110
Pjesa IV . . . . . " 113
Pjesa V . . . . . " 116

OFICER I POSAÇËM I SHTABIT . . . . . " 119

FORMA E TERENIT:

Pjesa I . . . . . " 124
Pjesa II . . . . . " 126
Pjesa III . . . . . " 128
Pjesa IV . . . . . " 130